


Standardet e përgjithshme për arritjet në fund të arsimit dhe edukimit
të mesëm të përgjithshëm dhe profesional në pjesën që ka të bëjë
me lëndët e përgjithshme për arsim

për lëndën

GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE



Standardet e përgjithshme të arriturave për fundin e arsimit të përgjithshëm të mesëm dhe arsimit dhe edukimit të mesëm profesional në pjesën e lëndëve të përgjithshme arsimore

GJUHË DHE LETËRSI SHQPE

Botues

Enti për Vlerësimin e Cilësisë së Arsimit dhe Edukimit

Për botuesin:

Dr. Branisllav Rangjelloviq

Redaktor:

...

Autore:

Naile Mala Imami

Bashkëpunëtor

Bekim Ademi

Lektura dhe korektura:

Naile Mala Imami

Dizejni:

Miroslav Jovanović

Materialin mund ta gjeni në adresën URL:

www.ceo.edu.rs

Tirazhi: 6 ekzemplarë

ISBN

PËRMBAJTJA

1. Standardet e përgjithshme të të arriturave	3
1.1. Kompetencat e përgjithshme dhe ndërlëndore për fundin e arsimit të mesëm	5
2. Për standardet për arsim për lëndën Gjuhë dhe letërsi shqipe	11
2.1. Fusha: GJUHA	15
2.2. Fusha: LETËRSI	32
2.3. Fusha: KULTURË GJUHE	56
3. Literatura	67

1. STANDARDET E PËRGJITHSHME TË TË ARRITURAVE

Për nocionin e standardeve arsimore

Në sistemin tonë të arsimit, sipas dispozitave të Ligjit për bazat e sistemit të arsimit dhe edukimit (2009), u parashikua përkufizimi i disa grupeve të standardeve, në mesin e të cilave janë edhe standardet e të arriturave të nxënësve, përkatësisht pjesëmarrësve. Meqenëse tashmë janë duke u aplikuar standardet e përgjithshme të të arriturave për fundin e ciklit të parë dhe të dytë të arsimit fillor dhe për ciklin e parë dhe të tretë të arsimit fillor për të rritur, me aprovimin e standardeve që kanë të bëjnë me arsimin e mesëm është rumbullakësuar procesi i standardizimit të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave të cilat nxënësit duhet t'i zhvillojnë deri në arsimin universitar.

Procesi i përpilimit të standardeve

Standardet i kanë zhvilluar grupet e veçanta të punës. Anëtarët e grupeve të veçanta janë zgjedhur ashtu që të angazhohen në punë arsimtarët, profesorët e universitetit për lëndë të caktuara, pedagogët, psikologët dhe profesionistët nga Enti për Vlerësimin e Cilësisë së Arsimit dhe Edukimit dhe Entit për Përparimin e Arsimit dhe të Edukimit. Me rastin e hartimit të standardeve grupet e punës dhe Enti e kanë pasur mbështetjen e ekspertëve nga Projekti “Përkrahja e sigurimit të cilësisë së sistemit të lëndëve përfundimtare në nivel kombëtar në arsimin fillor dhe të mesëm”.

Standardet për arsimin e mesëm të përgjithshëm janë bazuar në kompetenca të cilat duhet t'ua mundësojnë nxënësve që me sukses të përgjigjen në sfidat e ndryshme jetësore në situata të ndryshme të jetës (arsimore, shoqërore, kulturore interpersonal, praktike, etj.). Që të jenë kompetentë të përgjigjen me sukses në sfida të tilla, nxënësit duhet të fitojnë dhe të përdorin forma të ndryshme të njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve, d.m.th., duhet të zhvillojnë **kompetencat e bazuara në njohuri**. Prandaj standardet duhet të përshkruajnë çfarë dinë nxënësit dhe çfarë mund të bëjnë në nivele të ndryshme të zhvillimit të kompetencave, d.m.th., sipas standardeve matet niveli i kompetencave të caktuara që është arritur në fund të shkollës së mesme.

Tri standarde (nivele të të arriturave) janë përkufizuar për secilën kompetencë - *bazë, i mesëm dhe i përparuar*. Secili standard (nivel) i përkufizon njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet të cilat nxënësit duhet t'i kenë, si edhe me cilat sfida mund të vazhdojnë që ta plotësojnë këtë standard (nivel). Tri standarde (nivele) janë kumulative dhe janë përcaktuar edhe njëri edhe tjetri ashtu që nxënësit në nivelin e përparuar i plotësojnë kërkesat e të tri niveleve.

Niveli bazë i standardeve e përkufizon nivelin e të arriturave në kompetenca të caktuara (njohuri, shkathtësi dhe qëndrime) të cilat nxënësi duhet t'i ketë që në mënyrë aktive dhe produktive të marrë pjesë në forma të ndryshme të jetës (shoqërore, ekonomike, arsimore, familjare, personale, etj.).

Niveli i mesëm i standardeve e përkufizon nivelin e të arriturave në kompetenca të caktuara (njohuri, shkathtësi dhe qëndrime) të cilat nxënësi duhet t'i ketë që me sukses të mund të vazhdojë arsimin në fakultet në fusha të ndryshme.

Niveli i përparuar i standardeve e përkufizon nivelin e të arriturave në kompetenca të caktuara (njohuri, shkathtësi dhe qëndrime) të cilat nxënësi duhet t'i ketë që të mundet me sukses të vazhdojë arsimin në fakultet në fushat për të cilat këto kompetenca paraqesin sidomos kusht të rëndësishëm.

Korniza 1. Termat kryesorë – struktura e standardeve

Kompetenca e standardeve në mënyrë përshkuese përkufizohen për cilat sfida të veçanta të ndërlikueshmërisë graduale nxënësit mund të përgjigjen në nivel të caktuar të kompetencave (bazë, i mesëm dhe i përparuar).

Kompetencat e përgjithshme dhe ndërlëndore janë përshkrim narrativ i atyre kompetencave të cilat bazohen në integrimin e njohurive dhe të shkathtësive të ndryshme të cilat zhvillohen në kuadër të lëndëve të ndryshme dhe në bazë të programit mësimor.

Kompetenca e përgjithshme e lëndëve paraqet përshkrim narrativ se çfarë dinë nxënësit dhe çfarë mund të bëjnë në arsimin bazë të cilin e fitojnë në kuadër të lëndës individuale. Kompetenca e përgjithshme lëndore e përshkruan qëllimin definitiv për mësimin e një lënde të dhënë.

Kompetencat e veçanta të lëndëve paraqesin përshkrim narrativ të aftësive specifike të nxënësit të cilat ia mundësojnë që të zhvillojë kompetencën e përgjithshme të lëndës.

Standardet shërbejnë për procesin e të arriturave të nxënësve në zhvillimin e kompetencave të caktuara. Standardet i përkufizojnë të priturat lidhur me të arriturat e nxënësit në nivele të ndryshme të zhvillimit të kompetencave. Standardet gjithashtu shërbejnë si kriter për vlerësim. Përkufizohen si a) „shprehje të standardit“ dhe b) „standardet e kompetencave“ (shih përkufizimin e mëtejshëm në tekst).

Shembuj:

- Nxënësi i cili i plotëson vetëm standardet bazë mund të kuptojë tekstin informativ për temën për të cilën ka njohuri.
- Nxënësi i cili e plotëson standardin e përparuar mundet në mënyrë kritike të vlerësojë zgjidhje të ndryshme të ndonjë problemi në rrethana të panjohura.

Shprehjet e standardeve përkufizojnë njohuri konkrete, shkathtësi ose qëndrime të cilat nxënësit duhet t'i fitojnë në një fushë të caktuar të mësimin, në nivel të caktuar të standardeve.

Shembull:

- Nxënësi mund të shkruajë një pasqyrë përmbledhëse lidhur me librin, shfaqjen teatrale, filmin e të ngjashme.
- Nxënësi di të zgjidhë barazime me dy të panjohura.

Rezultatet i përkufizojnë rezultatet e pritura të mësimin, ato janë ajo që realizohet gjatë procesit mësimor. Rezultatet përkufizohen në nivel të kompetencave të përgjithshme dhe ndërlëndore të standardeve të arritura për secilin vit të mësimin.

Në procesin e hartimit të standardeve është aplikuar qasja në të cilën zëvendësohet vlefshmëria e ekspertëve me atë empirike.

Raporti i standardit dhe programit mësimor/kurrikulës

Në sistemin tonë të arsimit programet mësimore ende gjithnjë janë të konceptuara në mënyrë tradicionale ashtu që përmbajnë qëllimet, detyrat dhe regjistrimin e përmbajtjeve mësimore. Procesi i hartimit të kurrikulave i cili do të përmbajë rezultatet e mësimit për secilën lëndë është në zhvillim e sipër. Kur kështu kurrikula e përkufizuar do të fillojë të aplikohet, lidhja natyrore midis standardit dhe rezultatit të kurrikulave të përcaktuara do të jetë e qartë dhe mësimdhënësit, duke e planifikuar mësimin e orientuar në rezultate, nuk do të kenë shumë mëdyshje rreth vendit të standardeve në procesin e mësimit. Në periudhën deri sa kjo nuk ndodh, para mësimdhënësve gjendet një detyrë sfiduese që të planifikojnë mësimin duke u udhëhequr në rezultatet e pritura të mësimit, të cilat janë përshkruar në standard, por me këtë rast duke mos i lënë anash përmbajtjet e planifikuara me program mësimor.

1.1. KOMPETENCAT E PËRGJITHSHME DHE NDËRLËNDORE PËR FUNDIN E ARSIMIT TË MESËM

Programet mësimore të lëndëve të përgjithshme arsimore në Serbi, në nivelin e shkollave fillore dhe në nivelin e shkollave të mesme, deri më tani i kanë përcaktuar qëllimet arsimore për disa lëndë mësimore, por jo edhe në nivel të kompetencave si rezultat i mësimit që formohen dhe mbështeten me punë të përbashkët të disa disiplinave të veçanta shkollore. Praktika e deritashme e njëj punën e koordinuar dhe simulative, të dy ose më shumë disiplinave me rastin e përpunimit të një teme (koleracioni midis lëndëve). Në këtë dokument janë përkufizuar fushat e reja, relevante për zhvillim personal, profesional dhe social dhe funksionimin e individit, në të cilat kompetencat fitohen me integrim fleksibël dhe dinamik dhe me aplikimin e njohurive nga lëndët e mësuara.

Raporti i lëndëve të veçanta dhe i kompetencave të përgjithshme dhe ndërlëndore

Orientimi i procesit të arsimit në drejtim të kompetencave të përgjithshme dhe ndërlëndore nuk domethënë përfshirje e lëndëve të reja pas orëve të tjera plotësuese të cilat i përkushohen në mënyrë tematike një kompetence të caktuar, por përfshirja e kompetencave të përgjithshme dhe ndërlëndore në lëndë të llojllojshme të mësimit. Kjo arrihet në disa mënyra.

Së pari, rezultatet për lëndë përkufizohen ashtu që përmes tyre vendoset lidhja me kompetencat e përgjithshme dhe ndërlëndore. Me fjalë të tjera, njohuritë dhe shkathtësitë lidhur me lëndët të cilat bazohen në këto njohuri, përveç në ndonjë lëndë të saktë, përkufizohen edhe në kontekstin e kompetencave të përgjithshme dhe ndërlëndore. Realizimi i rezultateve kështu të përkufizuara shpie në drejtim të zhvillimit në kompetenca të përgjithshme dhe ndërlëndore.

Së dyti, zhvillimit të kompetencave të përgjithshme dhe ndërlëndore i kontribuon edhe zhvillimi i kompetencave të lëndëve, sepse kompetencat e lëndëve vështirë mund të ndahen plotësisht nga ato të përgjithshme. Sado që të jenë të veçanta, kompetencat e lëndëve nuk mundën siç duhet të arsyetohen më nëse me asgjë nuk kontribuojnë që nxënësit të mësojnë dhe të jetojnë.

Si zhvillohen kompetencat?

Kompetencat zhvillohen:

- Duke e vënë nxënësin në situata të cilat kërkojnë përdorim të njëkohësishëm të kompetencave të lëndëve dhe atyre ndërlëndore. Kjo ndodh gjithnjë kur nga nxënësi presim që ta aplikojë ndonjë njohuri në situata të cilat nuk janë ripërsëritje ose modifikime të thjeshta të situatës në të cilën është përvetësuar njohuria, tashmë e një situatë të re dhe të ndryshme;
- aktivitetet e kërkimit dhe krijimit të ndërmarrjeve të reja;

- puna në grup dhe ndarja e roleve në kuadër të detyrave më të ndërlikuara të cilat mund të realizohen vetëm përmes bashkëpunimit të roleve të ndryshme dhe me më shumë pjesëmarrës, ashtu që secili nxënës e zhvillon përgjegjësinë personale sipas obligimeve; Mësimi i orientuar për zhvillimin e kompetencave kërkon bashkëpunim dhe punë të përbashkët të arsimtarit.

Cilat kompetenca janë kryesore për arsimin e të rinjve?

Në brendi, puna në kompetencat e përgjithshme dhe ndërlëndore nuk është punë konkurrencte në përmbajtje dhe kompetenca të cilat janë të lidhura drejtpërsëdrejti lidhur me lëndë të caktuara. Përkundrazi, kompetencat ndërlëndore janë një hap më përpara në të kuptuarit e lëndës dhe në aplikimin e asaj që është mësuar, kurse përgjegjësinë për zhvillimin e tyre e mbajnë të gjithë arsimtarët dhe lëndët mësimore. Kjo domethënë që mbështetja e kompetencave të përgjithshme dhe ndërlëndore kërkon planifikim të përbashkët në nivel të ekipeve në shkollë, aplikimin e formave interaktive dhe aktive të mësimin, si edhe autonomi më të madhe të shkollës dhe arsimtarëve në realizimin e rezultateve në arsim.

Si të përcillet vlerësimi i kompetencave?

Në këtë dokument kompetencat e përgjithshme dhe ndërlëndore janë përkufizuar si obliguese, kurse rezultatet e pritura për secilën nga kompetencat janë vetëm në nivelin themelor, bazik. Format e ndryshme të vlerësimit bazik janë mënyra më e përshtatshme për përcjelljen e përparimit individual të nxënësit dhe për orientimin e zhvillimit të tyre të mëtejme.

Këtu do të japim disa rregulla dhe procedura në procesin e përcjelljes dhe të vlerësimit të kompetencave të përgjithshme që duhet pasur parasysh te nxënësit:

- Zhvillimin e kompetencave e përcjellin arsimtarët bashkë me nxënësit.
- Arsimtarët bashkëpunojnë dhe bashkërisht e vlerësojnë zhvillimin e kompetencave të nxënësve të vet.
- Procesi i përcjelljes sipas karakterit është më parë formativ se sa sumativ.
- Në vlerësime merren parasysh shembujt të cilët e ilustrojnë zhvillimin e kompetencave.
- Në vlerësim merren parasysh edhe vetëvlerësimet e nxënësit, e jo vetëm vlerësimet e arsimtarit. Rëndësi e madhe i kushtohet cilësisë, në vend të të dhënave kryesisht atyre sasiore dhe treguesve.
- Vlerësimi përmban përshkrimin e anëve të fuqishme dhe të dobëta të zhvillueshmërisë së kompetencave dhe propozimet për përparimin e mëtejme, e jo vetëm gjykimin për nivelin e zhvillueshmërisë

Kompetenat për mësimin gjatë tërë jetës

Zhvillimi personal dhe profesional i individit në radhë të pari bazohet në aftësitë e tij të menaxhojë procesin e mësimin. Nxënësi duhet të aftësohet ta iniciojë mësimin, t'i zgjedhë strategjitë e mësimin dhe të dizajnojë kontekstin në të cilin mëson, të përcjellë dhe të kontrollojë përparimin gjatë mësimin, të menaxhojë me mësimin në pajtim me qëllimet të cilat i ka. Nxënësi di të gjejë dhe të asimilojë njohuri dhe shkathtësi të reja duke përdorur në radhë të parë mësimin dhe përvojën jashtë shkollës. Aplikon njohuri në situata të ndryshme, varësisht nga karakteristikat e situatës dhe të qëllimeve të veta.

- Nxënësi di të planifikojë kohën për mësim dhe të organizojë procesin e mësimin dhe të menaxhimit.

- Në mënyrë aktive të fitojë njohuri; ta vërejë strukturën e lëndës, në mënyrë aktive të bëjë zgjedhjen e të njohurës nga e panjohura, të asaj që është e rëndësishme nga ajo e parëndësishme; di të bëjë rezymen dhe të elaborojë idetë themelore.
- Në mënyrë efikase i përdor strategjitë e ndryshme të mësimit, ia përshtat natyrës së lëndës dhe qëllimeve të mësimit.
- Njeh lloje të ndryshme të teksteve dhe di të zgjedhë strategjinë adekuate të leximit.
- Të dallojë faktet nga interpretimi, qëndrimet, besimet dhe mendimet; të dallojë dhe të prodhojë argumente për një tezë të caktuar, të dallojë argumentet siaps forcës dhe rëndësisë.
- Di të vlerësojë suksesin e vet në mësim; të identifikojë vështirësitë në mësim dhe di si t'i tejkalojë

2. Komunikimi

Nxënësi mbizotëron modalitete të ndryshme të komunikimit dhe i përdor në mënyrë tipike dhe konstruktive kur komunikon në kontesktin privat, publik, arsimor dhe profesional. Nxënësi ua përshtat mënyrën dhe mjetet e komunikimit veçorive të situatës (objektivit në lëndën e komunikimit, kapaciteteve të komunikimit dhe veçoritë e partnerit në komunikim, itd.). Përdor në mënyrë përkatëse dhe krijuese nocionet, gjuhën dhe stilin e komunikimit që janë specifike për disiplina të ndryshme shkencore, teknike dhe artistike. Në komunikim me të tjerët di të shprehet (të shprehë mendimin, ndjenjat, qëndrimet, vlerat dhe identitetin e vet) dhe të realizojë qëllimet e veta në mënyrë pozitive, konstruktive dhe argumentuese duke e respektuar tjetrin. Në mënyrë kritike e vlerëson përmbajtjen dhe mënyrën e komunikimit në situata të ndryshme të komunikimit. Nxënësi ka vetëdije të zhvilluar për rëndësinë pozitive dhe komunikimit konstruktiv dhe në mënyrë aktive i kontribuon kultivimit të kulturës së dialogut në bashkësinë të cilës i takon.

- Në mënyrë aktive i kontribuon kultivimit të kulturës së dialogut, e respekton dhe e kultivon llojllojshmërinë dhe i respekton normat themelore të komunikimit.
- Nxënësi i njeh karakteristikat e veçanta të modaliteteve të ndryshme të komunikimit (komunikimi me gojë dhe me shkrim, i drejtpërdrejtë dhe indirekt, psh., me telefon, përmes internetit).
- Di qartë të shpjegojë një përmbajtje të caktuar, me gojë dhe me shkrim, dhe t'ua përshtatë kërkesave dhe veçorive të situatës: i respekton veçoritë e zhanreve, kufizimet në pikëpamje të gjatësisë, destinimin e prezantimit dhe nevojat e auditoriumit.
- E respekton bashkëbiseduesin – reagon ndaj përmbajtjes së komunikimit, e jo ndaj personalitetit të bashkëbiseduesit; identifikon pozitën (këndin e vështrimit) të bashkëbiseduesit dhe di që në mënyrë adekuate ta argumetojë dhe të japë argumente kundër për këtë pozicion.
- Në situatën e komunikimit i shpreh qëndrimet, mendimet, ndjenjat, vlerat dhe identitetin e vet në mënyrë pozitive, konstruktive dhe argumentuese që të realizojë qëllimet e veta dhe që të zgjerojë të kuptuarit e botës, njerëzve dhe bashkësve të tjera.
- Nxënësi përdor në mënyrë përkatëse dhe në mënyrë krijuese gjuhën dhe stilin e komunikimit që janë specifike ndaj disa disiplinave shkencore, teknike dhe artistike.

3. Puna me të dhënat dhe informacionet

Nxënësi e kupton rëndësinë e shfrytëzimit të të dhënave të sigurta për punë, miratimin e vendimeve dhe jetën e përditshme. Përdor njohuri dhe shkathtësi nga lëndët e ndryshme që të parfaqësojë, të lexojë dhe të interpretojë të dhëna duke përdorur tekstin, numrat, diagramet dhe format e ndryshme audio-vizuale. Nxënësi përdor burime të ndryshme të informacioneve dhe të dhënave (bibliotekat, mediat, internetin, komunikimin personal, etj.), dhe e shqyrton në mënyrë kritike sigurinë dhe vlefshmërinë e tyre. Në mënyrë efikase i gjen, i përzgjedh dhe i integron informacionet kryesore nga burimet e ndryshme.

- Di që për të kuptuar ngjarjen dhe për marrjen e vendimeve kompetente është e nevojshme të ketë të dhëna relevante dhe të sigurta.
- Di të krahasojë burime të ndryshme dhe mënyrat e marrjes së të dhënave, të vlerësojë sigurinë e tyre dhe të dallojë shkaqet dhe gabimet e mundshme.
- Përdor pasqyrën tabelare dhe grafike të të dhënave dhe di që të dhënat e pasqyruara kështu t'i lexojë, t'i interpretojë dhe t'i aplikojë.
- Përdor teknologji informative për ruajtjen, prezantimin dhe përpunimin themelor të të dhënave.
- Di dallimin midis të dhënave dhe interpretimit të tyre, e di që të njëjtat të dhëna, varësisht nga konteksti, mund të kenë interpretime të ndryshme dhe që interpretimet mund të jenë të njëanshme.
- E kupton dallimin midis të dhënave publike dhe private, e di cilat të dhëna mund t'i marrë nga institucionet kompetente dhe i përdor rregullat themelore të ruajtjes së privatësisë së të dhënave.

4. Kompetenca digjitale

Nxënësi është i aftë t'i përdorë mjetet në disponim nga fusha e teknologjisë informative-komunikuese (aparartet, produktet softuerike, shërbimet elektronike të komunikimit dhe shërbimet të cilat përdoren me anë të komunikimeve elektronike) me përgjegjësi dhe në mënyrë kritike të plotësimit të qëllimeve të dhëna dhe detyrave në jetën e përditshme, shkollim dhe në punë të ardhshme. I njeh karakteristikat themelore të teknologjive për komunikim dhe informim (në tekstin e mëtejme: TIK) dhe mundësitë e aplikimit të tyre në jetën e përditshme, në punë dhe arsim, përkatësisht ndikimi i tyre në jetë dhe puna e individit dhe e bashkësisë. Duke pasur parasysh qëllimet dhe detyrat e vëna, di të zgjedhë teknologjinë përkatëse të informimit dhe komunikimit dhe ta përdorë në mënyrë krijuese dhe me përgjegjësi në aktivitete të cilat i zbaton për shkak të saj (komunikimi, bashkëpunimi, pjesëmarrja në jetën e bashkësisë; mësimi; zgjidhja e problemit; transaksioni; planifikimi, organizimi dhe menaxhimi i aktiviteteve të pavarura dhe të përbashkëta.

5. Zgjidhja e problemit

Nxënësi i angazhon kapacitetet e veta individuale (njohuritë nga lëndët e ndryshme, përvojën e fituar jashtë shkollës, si edhe aftësitë intelektuale, emocionale dhe sociale (dhe burimet e tjera të cilat i ka në disponim (burimet e ndryshme të informimit, veglat, librat, përvojën e nxënësve të tjerë, arsimtarit dhe personave të tjerë nga ambienti i shkollës dhe jashtë shkollës, etj.), në mënyrë përzgjedhëse dhe tipike i përdor, përpiqet të zgjidhë problemet dhe gjen/ideon zgjidhje të efektshme për përkufizim të qartë ose relativisht të qartë të situatës problematike për të cilën nuk ekzistojnë zgjidhje të qarta, e të cilat paraqiten gjatë mësimit dhe me rastin e pjesëmarrjes në jetën e shkollës.

- Nxënësi gjen/ideon zgjidhje të mundshme për situatat problematike.
- Nxënësi i krahason zgjidhjet e mundshme të situatave problematike përmes kriterëve relevante, di të shpjegojë çfarë janë përparësitë dhe dobësitë e zgjidhjeve të ndryshme dhe të orientohet për zgjidhen më të mirë.
- Nxënësi përgatit aplikimin e zgjidhjes së zgjedhur, e përcjell aplikimin duke e krahasuar me njohuritë e reja të cilat i fiton gjatë aplikimit të zgjidhjes së dhënë dhe arrin të zgjidhë situatën problemore.
- Nxënësi e vlerëson aplikimin e zgjidhjes së dhënë, i identifikon anët e saj të mira dhe të këqija dhe i formulon rekomandimet për përvojën e ardhshme me një situatë të njëjtë ose të ngjashme për një situatë problematike.

6. Bashkëpunimi

Nxënësi është i aftë që në bashkëpunim me të tjerët ose si anëtar i grupit të angazhohet në zgjidhjen e përbashkët të problemit ose për realizimin e projekteve të përbashkëta. Merr pjesë në aktivitete të përbashkëta në mënyrë konstruktive, me përgjegjësi dhe krijuese duke e afirmuar frymën e respektimit të ndërsjellë, barazisë, solidaritetit dhe bashkëpunimit.

- Në mënyrë konstruktive, të argumentuar dhe krijuese i kontribuon punës në grup, në harmonizimin dhe realizimin e qëllimeve të përbashkëta.
- Kontribuon në arritjen e marrëveshjes për rregullat e punës së përbashkët dhe u pëmbahet gjatë punës së përbashkët.
- Dëgjon në mënyrë aktive dhe shtron pyetje relevante duke i respektuar bashkëbiseduesit dhe bashkëpunëtorët, kurse diskutimin e bazon në argumente.
- Në mënyrë konstruktive i kontribuon zgjidhjes së detyrave në mendimin dhe qëndrimet dhe me këtë rast i respekton të tjerët si anëtarë të barabartë të grupit

7. Pjesëmarrja me përgjegjësi në shoqëri demokratike

Nxënësi është i aftë që në mënyrë aktive, kompetente, kritike dhe me përgjegjësi të marrë pjesë në jetën e shkollës, bashkësisë të cilës i takon, si edhe në shoqërinë më të gjerë demokratike, i udhëhequr nga të drejtat dhe përgjegjësitë të cilat i ka si pjesëtar i bashkësisë dhe si qytetar. I pranon dhe i respekton të tjerët si persona të pavarur të vlefshëm dhe të barabartë. Merr pjesë në aktivitete dhe i kontribuon bashkësisë në ruajtjen dhe kultivimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të minoriteteve, vlerave humaniste dhe vlerave dhe parimeve themelore demokratike. E përdor të drejtën e zgjedhjes së kulturës, subkulturës dhe traditës të cilën do ta kultivojë dhe do ta afirmojë, duke e respektuar të drejtën e të tjerëve që të kultivojnë dhe të afirmojnë ndonjë kulturë, subkulturë ose traditë tjetër.

- Merr pjesë aktive në jetën e shkollës dhe në bashkësi ashtu që i respekton pjesëmarrësit e tjerë si persona të barabartë, të vlefshëm dhe të pavarur dhe të drejtat e njeriut dhe të pakicave ashtu që i kundërshton format e ndryshme të dhunës dhe të diskriminimit.
- me aktivitetet e veta në shkollë dhe bashkësi e afirmon frymën e tolerancës, llojllojshmërisë dhe dialogut.
- Në mënyrë kritike dhe të argumentuar merr pjesë në shqyrtimin e çështjeve të hapura për të cilat është i interesuar duke i respektuar dallimet në mendim dhe interesimet dhe e jep kontributin personal për arritjen e marrëveshjes.
- e shpreh në mënyrë afirmative identitetin e vet dhe i respekton kulturat dhe traditat e tjera dhe kështu i kontribuon frymës së interkulturalitetit.
- Përpiqet për solidaritet dhe merr pjesë në aktivitete humanitare.

8. Ka qëndrim me përgjegjësi ndaj shëndetit

Nxënësi mbledh informacione për temat lidhur me rreziqet, ruajtjen dhe përparimin e shëndetit psikofizik. Gjykon rrethana relevante dhe, sipas nevojës, merr vendime dhe/ose angazhohet në aktivitete të rëndësishme për parandalimin e sëmundjes dhe ruajtjen e shëndetit. Është i vetëdijshëm për të gjitha dimensionet e shëndetit (shëndeti fizik, mendor, social, emocional). I njeh faktorët të cilët i kontribuojnë shëndetit ose e rrezikojnë dhe implikimet e veprimit të tyre ndaj individit, grupit ose bashkësisë. Me sjelljen e vet, si individ dhe si pjesë e grupeve dhe bashkësive të ndryshme, e promovon shëndetin, ruajtjen e shëndetit dhe stilet e shëndosha të jetës.

- I njeh përbërësit themelorë të ushqimit dhe ndryshimet të cilat ndikojnë në cilësinë e tij; e kupton rëndësinë e të ushqyerit të shëndetshëm dhe përpunimit adekuat të ushqimit për ruajtjen e shëndetit.
- I njeh karakteristikat e sëmundjeve themelore infektuese, shkaktuesit e tyre dhe masat e parandalimit.
- E kupton rëndësinë e barnave dhe mënyrës së rregullt të përdorimit të tyre për ruajtjen e shëndetit.
- I njeh pasojat e mundshme të përdorimit të nikotinit, dhe të substancave të tjera psikoaktive.
- E zgjedh stilin e jetës duke pasur parasysh anët e mira dhe rreziqet e asaj zgjedhjeje (psh., marrjen aktive me sport, ushqimi vegjetarian).
- Di të forojë ndihmën e parë

9. Veprimtaria ndërmarrëse dhe kompetenca ndërmarrëse

Përmes arsimit për veprimtarisë ndërmarrëse, nxënësi i mëson shkathtësitë dhe aftësitë organizuese, duke përfshirë shkathtësi të ndryshme interpersonale, si edhe organizimin e ambientit, menaxhimin e kohës dhe të të hollave. Nxënësi është i aftë për planifikim të ndërlikuar dhe vendimmarrje e cila e nënkupton respektimin e më shumë kushteve njëkohësisht. Di të ideojë projekte në pajtim me kërkesat që më parë të vëna. Di të njihet me veçoritë e punëve të caktuara dhe vendeve të punës, është i gatshëm që vullnetarisht të angazhohet dhe të përdorë mundësi të ndryshme që të fitojë përvojë pune.

- Nxënësi e kupton rëndësinë e aktivizimit personal dhe tregon nismën për njohjen me karakteristikat e tregut të punës (kërkesat e disa vendeve të punës, mënyrës së funksionimit të institucioneve, pozicionimin në botën e biznesit).
- I kupton parimet e funksionimit të tregut të punës dhe e kupton domosdoshmërinë e përsosjes së përhershme në pajtim me zhvillimin e tregut dhe me kërkesat e punëdhënësit.
- Di të identifikojë dhe në mënyrë adekuate të përfaqësojë aftësitë dhe shkathtësitë e veta;
- Di të shkruajë CV dhe letrën motivuese.
- Di të shprehë dhe të përfaqësojë idetë e veta, dhe të ndikojë ndaj të tjerëve, përmes zhvillimit të shkathtësisë së të folurit publik, negocimit dhe zgjidhjes së konflikteve.
- Ka aftësi të vendosë qëllime adekuate dhe reale duke i vlerësuar dhe duke i pranuar rreziqet;
- Di të komunikojë me punëdhënësit; di të negociojë; është i gatshëm të bëjë praktikën dhe të punojë vullnetarisht duke i respektuar marrëveshjet.

Standardet e përgjithshme për arritjet në fund të arsimit dhe edukimit të mesëm të përgjithshëm dhe profesional në pjesën që ka të bëjë me lëndët e përgjithshme për arsim

2.0. Për standardet për arsim për lëndën Gjuhë dhe letërsi shqipe

Standardet e përgjithshme për arritjet – standardet e arsimit në fund të mbarimit të shkollimit të përgjithshëm janë dokument i ri i cili ka rëndësi të jashtëzakonshme në përpjekjen që sistemi arsimor në Serbi të bëhet më bashkëkohorë dhe më i mirë. Është krijuar si dokument i tretë me radhë, pas dokumentit Standardet për arsim për fund të arsimit të obliguar dhe Standardet për arsim në fund të ciklit të parë të arsimit të obliguar. Këtë dokument e dallojnë këto cilësi:

1. Para se të theksohen arritjet e nxënësit (njohuria, shkathtësia, aftësitë) në të tri nivelet (bazë, i mesëm dhe i përparuar), janë theksuar kompetencat e përgjithshme për lëndët të cilat, në brendi, janë qëllimet më të rëndësishme (arsimore, edukative dhe funksionale) që do të realizohen në mësimin në shkollë të mesme.
2. Kompetencat e veçanta të lëndëve, gjithashtu janë diferencuar në tri nivele, dhe ndarë në dy fusha: *Gjuhë dhe letërsi*, gjë që është në pajtim me emërtimin e lëndës në shkollë të mesme – *Gjuhë dhe letërsi shqipe*.
3. Përmbajtjet nga gjuha dhe kultura e gjuhës janë integruar në trajtim dhe interpretim të teksteve letrare dhe artistike dhe të llojeve të tjera të teksteve, gjë që i kontribuon unitetit të nënfushave të kësaj lënde të përgjithshme për arsim.
4. Standardet e përgjithshme të arritjeve – standardet për arsim për fund të arsimit të përgjithshëm të mesëm për lëndën *Gjuhë dhe letërsi shqipe* i përmbajnë standardet e arritjeve për fushën *Gjuhë, letërsi dhe Kulturë gjuhësore*. Një klasifikim i këtillë më shumë i përgjigjet lëndës mësimore për të cilën bëhet fjalë nga ndarja e standardeve në dokumente për shkollë fillore. Pra, problem më i madh në të kuptuarit dhe lidhjes së përshkrimit të arritjeve të nxënësit dhe përmbajtjes së programit të mësimave ka paraqitur pikërisht ndarja në katër nënfusha kryesore: *Shkathtësia e leximit dhe të kuptuarit* e asaj që nxënësi e lexon, *Të shprehurit me shkrim, Gramatika, leksiku, gjuha popullore dhe letrare dhe Letërsia*, kurse në programe veçohen tri: *Gjuhë, letërsi dhe Kulturë gjuhësore*. Meqenëse shkathtësia e leximit me të kuptuarit e tekstit pandashëm kanë të bëjnë me leximin, përjetimin dhe interpretimin e tekstit letrar dhe artistik, në dokumentin për shkollë të mesme këto nënfusha gjenden të bashkuara. Në përshkrimin e arritjeve të nxënësit për shkollë fillore drejtshkrimi vendin e vet e ka gjetur në *Të shprehurit me shkrim* (gjë që në brendi është pjesë e *Kulturës së gjuhës*), kurse me programe shkollore kjo nënfushë konsiderohet pjesë e fushës *Gjuha* (bashkë me gramatikën dhe ortoepinë¹). Kjo ka shkaktuar edhe probleme në përshkrimin e standardeve (në tërësi ose në disa pjesë) bashkë me njësitë mësimore, me rastin e planifikimit të realizimit të përmbajtjeve mësimore, si edhe gjatë përgatitjes së arsimtarit për zhvillimin e mësimin. Në dokumentin për shkollë të mesme kjo mangësi është tejkaluar.
5. Edhe pse strukturimi i standardeve sipas niveleve ka mbetur i njëjtë si në dokumentet për shkollë fillore kuptimi i niveleve të arritjeve të nxënësit është më ndryshe. Përderisa në shkollë fillore niveli bazë ka të bëjë me numrin më të madh të nxënësve të cilët mund ta arrijnë, në shkollë të mesme ky nivel paraqet vëllimin e përgjithshëm të njohurive që mund t'i arrijë secili nxënës i shkollës së mesme i cili më tutje nuk do t'i zgjerojë njohuritë e veta

¹ Ortoepia paraqet shkencën për shqiptimin e drejtë të fjalës.

në ndonjë nga shkollat e larta ose fakultetet. Niveli i mesëm është sfidë për nxënësit të cilët do të tregojnë interesim që njohuritë e veta t'i zgjerojnë dhe t'i përkryejnë në fakultete të ndryshme, kurse niveli i përparuar ka të bëjë me nxënësit të cilët veçanërisht janë të interesuar për ndonjë profesion më të ngushtë – studimet filologjike, studimet e gjuhësisë, përkatësisht të gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Gjuhë dhe letërsi shqipe

Standardet e përgjithshme për arritjet për lëndën Gjuhë dhe letërsi shqipe për fund të shkollimit të përgjithshëm të mesëm dhe arsimit të mesëm profesional në pjesën që ka të bëjë me lëndët e përgjithshme për arsim

Kompetenca e përgjithshme e lëndës

Ka njohuri si nga fusha e gjuhës dhe letërsisë shqipe ashtu edhe e letërsisë botërore. E njeh komunikimin me gojë dhe me shkrim: flet dhe shkruan duke e respektuar normën e gjuhës standarde, e harton tekstin logjik me shkrim dhe me gojë në harmoni me stilin. E kupton dhe mendon në mënyrë kritike atë që e lexon, e ka fjalorin e pasur. Lexon, e përjeton dhe e interpreton veprën letrare; e përdor leximin që ta kuptojë veten më mirë, të tjerët dhe botën rreth vetes; i ka lexuar veprat më të rëndësishme letrare nga trashëgimia kulturore kombëtare dhe ajo botërore. E ka shprehur dhe e ndjen nevojën që ta zhvillojë kulturën e komunikimit dhe të leximit; si për të fituar njohuri për veten ashtu edhe për ta ruajtur dhe për ta pasuruar kulturës kombëtare.

Niveli bazë

Flet qartë gjuhën standarde. Lexon, kupton dhe i analizon tekstet letrare e joletrare. Dallon gjuhën letrare nga dialektet. Përdor gjuhën letrare duke u mbështetur në rregullat gramatikore të gjuhës shqipe. Përdor fjalë nga komunikimi i përditshëm. I njeh dhe i lexon autorët e veprave letrare, të cilët janë paraparë me plan dhe program mësimor. Në analizën e veprës letrare, arrin ta dallojë mënyrën stilistike të organizimit të veprave në përgjithësi, me elemente (figura) letrare (stilistike) duke dhënë edhe shembuj.

Di t'i interpretojë pjesët tematike (duke shprehur përshtypjet e veta) madje edhe duke dhënë shembuj për to. Nxënësi e përdor gjuhën shqipe që të mund të kuptojë, të shprehë dhe t'i përcjellë informacionet, mendimet, ndjenjat dhe qëndrimet e veta në situata të ndryshme.

Nxënësi fiton shprehur leximi dhe e ndjen nevojën që të lexojë tekste të ndryshme. Di të shkruajë dhe të hartojë tekste me përmbajtje, strukturë dhe destinim të ndryshim në të gjitha stilet e përdorimit.

Niveli i mesëm

E shpreh qartë mendimin e vet dhe gjatë të folurit e respekton normën e gjuhës standarde. Gjatë të shkruarit, përdor fjali të cilat janë në pajtim me rregullat gramatikore dhe përdor stile të ndryshme funksionale. Interpreton (shpjegon) elementet kryesore të tekstit të gjatë e të shkurtër. Lexon, kupton dhe di t'i zbërthejë tekstet letrare e joletrare. Jep mendim kritik dhe qëndrim personal për tekstin që e lexon.

Di për rëndësinë e gjuhës shqipe si një gjuhë e vjetër, po ashtu edhe për kulturën dhe historinë e shqiptarëve. Di etapat e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe (etapa e parë 1848-1879; etapa e dytë 1912-1944; etapa e tretë 1945-1972). Dallon fonemat, morfemat, fjalët, togfjalëshat, frazeologjizmat dhe fjalitë e gjuhës shqipe. Në të folur e të shkruar i zbaton rregullat e caktuara gramatikore të cilat janë të parapara me program mësimor.

Di ta dallojë gjininë, llojin dhe zhanrin e veprës letrare. Në analizën e veprës letrare, në radhë të parë e përcakton temën, jep përmbajtjen dhe i përcakton veçoritë gjuhësore të veprës artistike. Lexon lirshëm, e kupton dhe i interpreton tekstet përfaqësuese të letërsisë shqipe dhe të letërsisë botërore në bazë të përvojës dhe njohurive të veta letrare dhe e zhvillon mendimin kritik dhe shijen letrare.

Në interpretimin e veprës letrare (të paraparë me program) përdor gjinitë letrare. I dallon pjesët kryesore në tekst, analizon dhe i argumenton mendimet dhe qëndrimet e veta me fakte nga teksti në fjalë. Varësisht nga zhanri, aplikon strategji të ndryshme të leximit. Është i përgatitur mirë dhe i aftë (që në mënyrë të pavarur) ta zgjedhë pjesën letrare dhe ta shpjegojë para të tjerëve.

Niveli i përparuar

Nxënësi e përdorë literaturën profesionale për t'iu përmbajtur rregullave gramatikore të gjuhës. Lexon dhe jep mendim kritik për tekstin joartistik. Dallon dialektet e gjuhës shqipe dhe veçoritë e tyre. Di fazat e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe. Di që gjuha shqipe zë një vend të rëndësishëm në rrethin e gjuhëve indoevropiane, duke pasur një traditë të gjatë të të folurit dhe të shkruarit dhe kjo ka gjithashtu një rëndësi të madhe për kulturën shqiptare. Dallon alternimet e tingujve.

Nxënësi e di lakimin, zgjedhimin dhe rregullat sintaksore. Përdor gjuhën si mjet kryesor për komunikim. Lexon, shpjegon dhe i vlerëson veprat letrare të nivelit të mesëm, që janë të obligueshme për mësimin plotësues, duke u njohur më shumë me problematikën e një vepre letrare. Jep argumente për mendimin e vet lidhur me veprën letrare, duke u bazuar në tekstet parësore dhe dytësore. Gjatë interpretimit të tekstit letrar përdor edhe literaturë plotësuese.

Duke lexuar tekstin letrar e vënë në bashkë marrëdhënie me tekstet e tjera, e krahason dhe bën kundërshtime dhe kështu e krijon kuptimin dhe qëndrimin e vet. Gjithashtu është shumë me rëndësi që nxënësi të bëjë përzgjedhjen e teksteve sipas dëshirës së vet dhe pastaj ta japë mendimin e vet lidhur me të. Në këtë mënyrë nxënësi i zhvillon shkathtësitë e interpretimit, e lidh përvojën e vet dhe përvojën e fiksonit letrar. E nxit krijimtarinë në pajtim me mundësitë dhe interesimet e veta.

Kompetencat e veçanta të lëndës: GJUHA

Niveli bazë

Ka njohuri bazë për atë se çfarë është gjuha dhe cilat funksione i ka: e respekton gjuhën e vet dhe i respekton gjuhët e të tjerëve. Ka njohuri bazë për dialektin gegë dhe toskë e sidomos për normën e letrare të gjuhës shqipe; Flet qartë gjuhën standarde. Ka njohuri për pjesët e ligjëratës në gjuhën shqipe; ka njohuri bazë edhe për zhvillimin e drejttimeve letrare, për alfabetin dhe drejtshkrimin. Di ta analizojë përbërjen e fjalisë. Ka njohuri themelore për kuptimin e fjalëve; di për fjalorët më të rëndësishëm të gjuhës shqipe dhe di t'i përdorë. Di të shprehë qëndrimet e veta duke folur qartë dhe lirshëm, duke e respektuar drejtshkrimin; Në mbarim të shkollimit të mesëm e harton punimin e maturës duke i respektuar rregullat për hartimin e një punimi të tillë.

Niveli i mesëm

Ka njohuri të gjera për gjuhën në përgjithësi dhe njohuri bazë për gjuhët e botës, për ngjashmëritë e tyre të ndërsjella. Ka njohuri të gjera për tingujt e gjuhës shqipe: I di rregullat për theksimin e fjalëve dhe e dallon theksin letrar nga ai joletrar; ka njohuri të gjera për llojet dhe nënlojet e fjalëve, format e tyre dhe mënyrat e ndërtimit të tyre: I njeh llojet e fjalive dhe e analizon ndërtimin e fjalisë. E ka fjalorin e pasur dhe di ta përdorë fjalën përkatëse në pajtim me rastin; Është i interesuar që ta pasurojë fjalorin e vet. Lexon qartë dhe e respekton normën. E përdor literaturën

përkatëse dhe shkruan në mënyrë të harmonishme raporte dhe referate. Gjatë të shkruarit, përdor fjali të cilat janë në pajtim me rregullat e drejtshkrimit dhe përdor stile të ndryshme.

Niveli i përparuar

Ka njohuri të hollësishme për gjuhën në përgjithësi dhe njohuri të thelluara për gramatikën e gjuhës shqipe (theksin, përbërjen e fjalëve, kuptimin e rasave dhe të mënyrave foljore, për strukturën e fjalisë); Flet për temat e zgjedhura si folës i shkathët; me kujdes dëgjon dhe vlerëson reagimin verbal dhe joverbal të bashkëbiseduesit të vet dhe ia përshtat të folurit e vet. Në mënyrë të harmonishme shkruan ese, tekst profesional dhe artikuj për gazeta në mënyrë konsekuente duke aplikuar normën e gjuhës letrare. Diskuton për tema të ndërlikuara nga gjuha, letërsia dhe kultura të cilat janë caktuar me program mësimor; Ka njohuri të hollësishme për gjuhën në përgjithësi, si edhe për gramatikën e gjuhës shqipe. Ka njohuri të përgjithshme për fjalorët dhe për leksikografinë në përgjithësi.

Kompetenca specifike ndaj lëndës: LETËRSIA

Niveli bazë

Nxënësi lexon rregullisht vepra letrare, të cilat janë paraparë me plan dhe me program, di për përfaqësuesit kryesorë dhe për veprat nga letërsia shqipe dhe ajo botërore. Shkurtimeisht i përshkruan ndjenjat e veta dhe përjetimin e veprës letrare ose ndonjë vepër tjetër artistike. E interpreton tekstin letrar dhe e bashkon interpretimin me temën dhe me zhanrin. Di ta interpretojë një tekst të shkurtër letrar e të thjeshtë joartistik. Përmbledhtazi përshkruan ngjarjen e veprës letrare dhe i dallon veçantitë e kërkuara në tekst. Njih autorët e veprave letrare të paraparë me program shkollor. Di ta bëjë dallimin në mes të letërsisë gojore dhe artistike. Që në fillim paraqet elementet bazike të strukturës së veprës letrare; Di ta analizojë problemin që paraqitet në tekst letrar. Përshtypjet dhe përfundimet e veta i nxjerr me shembuj nga tekstet përzgjedhëse (letrare e joletrare).

Niveli i mesëm

Interpreton veprën letrare që kërkohet me plan dhe program mësimor dhe ka njohuri bazë për kuptimin letrar dhe historik, por edhe atë poetik që e përcaktojnë këto vepra. Në mënyrë të pavarur e vëren dhe i analizon kuptimet dhe aspektet e veprës letrare sipas stilit dhe di të argumentojë qëndrimet e veta në bazë të tekstit bazë. E kupton dhe e përshkruan funksionin e gjuhës në procesin krijues. Në interpretimin e veprës letrare i aplikon metodat adekuate dhe pikëpamjet e harmonizuara me metodologjinë e shkencës dhe përpunimit të veprave individuale. I vëren dhe i paraqet elementet e rëndësishme strukturore të veprës letrare: aspektin tematik, gjuhësor e stilistik të saj duke i emëruar me terma të përshtatshëm letrarë. Njih strategjitë e leximit dhe mund t'i përdorë në mënyrë adekuate. Në mënyrë të pavarur zgjedh veprat për lexim nga opusi i letërsisë për fëmijë. Shpreh kureshtjen dhe emocionin, kupton rëndësinë e leximit për zhvillim të përgjithshëm të dijes dhe të kulturës së tij.

Niveli i përparuar

Kërkon, lexon, interpreton (shpjegon) dhe vlerëson (është kritik) veprat letrare nga niveli i mesëm, kryesisht nga mësimi i paraparë me program mësimor dhe ai plotësues. Vëren problematikën e një teksti të caktuar letrar. Në mënyrë të argumentuar shpreh mendimin e tij për veprën letrare në bazë të teksteve parësore dhe dytësore. Analizon dhe krahason karakteristikat e veprës letrare (aspektin tematik, kompozicional, stilistik). Gjatë interpretimit të tekstit letrar, shfrytëzon edhe literaturë dytësore. Ka kulturë të theksuar të leximit. Argumenton gjykimin e tij për

veprën letrare dhe e vlerëson në bazë të kriterit të përcaktuar. Ka interesim për veprat letrare nga letërsia botërore. Shpreh dashuri dhe interesim për kulturën kombëtare dhe letërsinë, si dhe për kulturën dhe letërsinë e popujve të tjerë.

2.1. Fusha: GJUHA

Në këtë pjesë janë dhënë, aty ku kjo ka qenë e nevojshme, sqarime të shkurtra të standardeve të arsimit në fushën e *Gjuhës*. Secili standard realizueshmëria e të cilit mund të verifikohet me test – është ilustruar me një numër të caktuar detyrash.

NIVELI BAZË

2GJLSH.1.1.1. Ka njohuri bazë për gjuhën në përgjithësi (çfarë është gjuha. Çfarë funksioni ka) I respekton edhe gjuhët e tjera; I dallon stereotipet ndaj gjuhës. E kupton tekstin; I dallon pjesët e tekstit (hyrjen, pjesën kryesore, përfundimin); I dallon llojet e teksteve (Format e diskursit); Formon dhe shkruan tekste përshkuese dhe tregimtare për një temë të lirë sipas qëllimit të folësit dhe dëgjuesit; e cakton temën, formën, destinimin dhe qëllimin e të folurit/e formonn kuptimin dhe tekstin e strukturuar sipas logjikës dhe sipas veçorive të llojit të teksteve. Saktësisht dhe në mënyrë të efektshme përdor sinonimet, homonimet dhe fjalët shumëkuptimëshe.

1 – Njeriu me gjuhë mund të bartë informacione të ndryshme (në gjuhësi ky quhet funksion referues), i shpreh ndjenjat e veta, nxit bashkëbiseduesin për ndonjë gjë, vendos dhe mban kontakte, përcjell mesazh estetik, shpreh përkatësinë një grupi të caktuar shoqëror. Njeh shprehjet gjuhësore të urrejtjes si dukuri negative të shoqërisë.

2 - Dallon gjuhën letrare nga ajo dialektore. Çmon dialektin e vet dhe dialektin dhe nëndialektet e tjera të gjuhës shqipe. Dallon zanoret dhe bashkëtingëlloret. Zbaton normën letrare gjuhësore duke shqiptuar fonemat në mënyrë të drejtë. Vendos theksin në shembujt e dhënë. Gjatë të folurit dhe të shkruarit përdor fjalë me parashtesa dhe prapashtesa si: *mos, pa, mbi; im, je, tar, tor, ar* (mosbesim, padituri, mbishkrim, punim, anëtar, piktor, arsimtar etj.

3 - Dallon pjesët e ligjëratës. Zbaton normën letrare gjuhësore. Vëren ndryshimet fonetike në lidhje me format e fjalëve. Dallon kategoritë gramatikore të pjesëve të caktuara të ligjëratës (gjininë e emrit, numrin, lakimin, zgjedhimin, mënyrat e foljeve, kohët e foljeve...). Dallon fjalinë e thjeshtë nga fjalia e përbërë. Në mënyrë të pavarur ndërton fjalë në lidhje me detyrën e dhënë duke u bazuar në modelet ekzistuese.

4 - Gjen gjymtyrët kryesore të fjalisë (kryefjalën dhe kallëzuesin), por, njëkohësisht, edhe gjymtyrët e dyta të saj (përcaktorin, rrethanorin, kundrinorin). I dallon fjalët dhe togfjalëshat. Klasifikon llojet e fjalisë sipas funksionit dhe përmbajtjes. Dallon fjalinë e varur nga e pavarura.

5 - E di domethënien e fjalëve dhe shprehjeve (grupet e fjalëve me veçori të dallueshme), në të cilat mund të hasë gjatë procesit mësimor. E di që fjala në gjuhën shqipe mund të ketë shumë kuptime, siç janë: sinonimet, homonimet, antonimet, duke mësuar edhe më shumë për pasurinë leksikore të shqipes. E njeh leksikon e gjuhës shqipe.

6 - Flet në pajtim me rregullat drejtshkrimore dhe vlerat e të folurit: I thekson fjalët në fjali sipas theksit: e përdor theksin si mjet dallues, e përcakton siç duhet melodinë e fjalisë, duke përfshirë edhe ritmin, flet gjuhën standarde në pajtim me situatat e komunikimit. Nxënësi harton dhe shkruan tekste të ndryshme; I aplikon rregullat e drejtshkrimit dhe veçoritë e stilit funksional në pajtim me qëllimin e tekstit dhe me kontributin e dëshiruar atij që i referohet, siç janë: komentet, kritikën, eset, lutjet, ankesat dhe fletparaqitjet.

Detyra 1

2GJLSH.1.1.1.	Niveli bazë
Cilat funksione ka gjuha në këtë pjesë vjershe? Do vërshëllej ngadalë-ngadalë E s'do prish gjumin tënd të bukur Do bien mbi mua petale E do ulet në sup një flutur Nga <i>Dritëro Agolli</i> Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë. a) Funkzioni referues: gjuha transmeton disa informacione. b) Funkzioni emotiv: gjuha shpreh ndjenja. c) Funkzioni apelativ: gjuha shtyen bashkëbiseduesin. d) Funkzioni faktik: gjuha vendos dhe mban lidhje. e) Funkzioni poetik: gjuha transmeton porosinë estetike. f) Funkzioni simbolik-identifikues: gjuha shpreh përkatësinë e grupit shoqëror	
Zgjidhja	
a), b), e)	

Detyra 2

2GJLSH.1.1.1.	Niveli bazë
Rretho shkronjën para gjytimeve të sakta për gjuhët e botës. a) Në secilën gjuhë njerëzit mund të shprehen qartë dhe saktë. b) Dashuria mund të shprehet më së miri në gjuhën frënge. c) Disa gjuhë të veçanta kanë strukturë gramatikore më logjike se sa të tjerat d) Poezia mund të shkruhet në secilën gjuhë. e) Gjuha që ka më shumë folës vetvetiu është më e mirë se ajo që ka më pak folës.	
Zgjidhja	
a), d)	

Detyra 3

2GJLSH.1.1.1.	Niveli bazë
Cakto llojin e tekstit (formën e diskursit) në pjesën e mëposhtme Terri u dredh, e një rrigë e pruar e rrezeve të hënës e lau kreshtën e malit, luginën dhe u ngrit poshtë, atje mbi syprinën e lëmuar të lumit që rimon buzët dredharake të fushës. Çdo gjë është lidhur e shtrënguar mirë e mirë nga penjtë e qetësisë, nga penjtë e kësaj heshtjeje, e cila është e rëndë, e palëvizshme. Edhe qyqja hesht. As bulku nuk dëgjohej. Përgjigja _____	
Zgjidhja	
përshkrim/ deskripcioni/ tekst deskriptiv/ përshkrim sugjestiv/ deskripcioni sugjestiv	

2GJLSH.1.1.2. Dallon gjuhën letrare (standarde) nga dialekti; e di ndarjen në dialekte të gjuhës shqipe; ka njohuri për dialektin e saj dhe për dialektin tjetër të gjuhës shqipe si dhe për të folmet e tjera dhe kështu përdor fjalë apo shprehje nga e folmja e saj, nganjëherë edhe nga e folmja e palës tjetër, por gjithmonë është konservatore ndaj varietetit gjuhësor të cilit i përket. Me shembuj mund t’i paraqesë veçoritë që i dallojnë të dy dialaktet e shqipes (nga aspekti fonetik, gramatikor e leksikor) dhe kështu mund ta mësojë, ta ruajë e ta kultivojë edhe më shumë gjuhën letrare. Njeh gramatikat kryesore dhe librat normativë të shqipes, të cilat i përdor në situata të caktuara. E di që gjuha shqipe zë një vend të rëndësishëm në rrethin e gjuhëve indoevropiane, duke pasur një traditë të gjatë të të folurit dhe të shkruarit dhe kjo ka një rëndësi të madhe për kulturën shqiptare. Ka njohuri për etapat e zhvillimit të gjuhës letrare, fillimet e shkrimit të shqipes dhe rregullat e drejtshkrimit.

Detyra 4

2GJLSH.1.1.2.	Niveli bazë
Trego nëse teksti i radhës është shkruar në gjuhë standarde apo në dialekt:	
<p>E kisha vënë re disa ditë me radhë, kur dilte ora e fundit e mësimit, një çunak i vogël rrinte pranë portës së shkollës e më shikonte si me ndrojtje e me turp. Ishte i hollë në trup, i hequr në fytyrë dhe me sy të mëdhenj që i shkëlqenin si ullinj të zinj. Duhej të kishte dalë edhe ditë të tjera, por unë s’e kisha vënë re. Vetëm këto ditët e fundit e kuptova që më priste mua. Kishte diçka për të më thënë ose për të më dhënë, por nuk e vendoste dot. Dhe ashtu qe vërtet.</p> <p style="text-align: center;">Nga Gjergj Zhei</p> <p>a) gjuhë letrare (standarde) b) gegërishte c) labërishte (tosk.) d) çamërishte (tosk.)</p>	
Zgjidhja	
a)	

2GJLSH.1.1.3. E di nocionin e theksit. Në fjali mund t’i dallojë llojet e theksave (theks i lirë, dinamik, ritmik, logjik, i fjalisë). Mund t’i ndajë tingujt në: tinguj zanorë dhe bashkëtingëllorë dhe i bashkon në formimin e fjalëve duke u dhënë kuptim atyre. Kur shqipton me zë më të fortë ose me zë më të ngritur një fjalë a një pjesë të fjalisë, mund ta theksojë rëndësinë kuptimore të saj dhe kështu i heton dallimet eventuale në mes të theksit të tij nga ai letrar.

Detyra 5

2GJLSH.1.1.3.	Niveli bazë
Në fjalinë “Ai nuk erdhi në dasmë”, theksi logjik bie mbi fjalën (rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:	
<p>a) Ai b) nuk c) erdhi d) dasmë</p>	
Zgjidhja	
c)	

2GJLSH.1.1.3. Dallon shqiptimin e drejtë nga ai i padrejtë të tingujve. E di ndarjen e tingujve¹; ka njohuri bazë lidhur me rrokjen dhe i aplikon rregullat në ndarjen e fjalëve në rrokje²; i di rregullat themelore të normës dhe i vëren dallimet midis theksit të vet dhe atij letrar³.

1 – Ndarja kryesore e tingujve përshin atë që nxënësve u nevojitet që t’i zotërojnë me sukses alternimet e tingujve që janë të rëndësishëm për drejtshkrim (gjë që do të duhej t’i dinin nga shkolla fillore). E di që: (1) të gjithë tingujt ndahen në zanore dhe bashkëtingëllore, (2) dallon grupet e diftongjeve. (3) ndarjen e bashkëtingëlloreve në të zëshme dhe të pazëshme; (4) dallon ndarjen e bashkëtingëlloreve sipas vendit të formimit;

2 – Kjo domethënë që e kupton nocionin e rrokjes, i dallon rrokjet e hapura dhe të mbyllura, i ndan fjalët në rrokje/sipas të dëgjuarit përkatësisht sipas pjesëve fjalëformuese.

3 – Fjala është për faktin që nxënësi *di* të vërejë këtë dallim, por edhe ka *shprehi* dhe *nevojë* që këtë ta bëjë, që ta harmonizojë shqiptimin e vet me normën letrare gjuhësore kur kjo është e nevojshme dhe që në këtë drejtim të vazhdojë ta zbatojë edhe pasiqë ta përfundojë shkollën e mesme.

Detyra 6

2GJLSH.1.1.3.	Niveli bazë
Nga fjala ATDHEU ndaj:	
1) zanoret 2) bashkëtingëlloret	
Zgjidhja	
a, e, u t,dh	

Detyra 7

2GJLSH.1.1.3.
-Ndaj fjalët e poshtëshënuara sipas rregullave drejtshkrimore - pushka - kodra - partia - gjimnastika - pranvera - industria
Zgjidhja
Pu-shka Ko-dra Par-ti-a Gjim-na-sti-ka Pran-ve-ra I-ndu-stri-a
Pikat

2GJLSH.1.1.4. E di përkufizimin e fjalës dhe veçoritë e saj. Njeh njësitet themelore të gjuhës (fonemën, morfemën, fjalën, togfjalëshin dhe fjalinë). Ndan fjalët në njësi më të vogla gjuhësore si p.sh.: fjalët *për-pun-oj*, *kënd-o-j* etj, Fjalën mund ta analizojë nga aspekti gramatikor me parashtesa, prapashtesa e mbaresa¹. Njeh mënyrat elementare të ndërtimit të fjalëve².

1- Kjo do të thotë që i dallon parashtesat, prapashtesat dhe mbaresat; di të caktojë pjesët e ligjëratës dhe të trejojë se kuptimin e tyre.

2 - Nxënësi di të dallojë fjalitë e thjeshta nga ato të përbëra dhe jep shpjegimet e duhura për to.

Detyra 8

2GJLSH.1.1.4.	Niveli bazë
Në fjalën çarmatos ç është: a) parashtesë b) prapashtesë	
Zgjidhja	
a)	

Detyra 9

2GJLSH.1.1.4.	Niveli bazë
Cilës klasë të fjalëve i takon fjala me vizë në shembullin e dhënë: Prej asaj nate <u>nuk</u> ndjeva asgjë. a) emër b) përemër c) folje d) pjesëz e) parafjalë	
Zgjidhja	
d)	

Detyra 10

2GJLSH.1.1.4.	Niveli bazë
Lexo tekstin më poshtë dhe dallo fjalën e nënvizuar nëse është e fjalë e thjeshtë apo fjalë jo e thjeshtë. Më lër të pushoj nën palat e flamurit tim që e kam mbrojtur me gjak dhe i thuaj Skënderbeut, mbretit tonë të <u>lavdishëm</u> , këto fjalë: “Edhe i vdekur, Pal Golemi do t’i tmerrojë armiqtë. Nga Gavril Dara i Riu Fjalë e thjeshtë Fjalë jo e thjeshtë	
Zgjidhja	
b)	

2GJLSH.1.1.5. Fjalinë e shkruan sipas rregullave gramatikore; dallon trajtën e shumësit të emrave. Mund t'i klasifikojë njësitë sintaksore¹; analizon fjalitë e thjeshta dhe ato të përbëra³. Kjo do të thotë që e dallon: fjalën, fjalinë, togfjalëshin

1 – kjo domethënë që e dallon: a) fjalën, b) togfjalëshin (si njësi sintaksore) dhe gjymtyrët e fjalisë.

2 - e di që fjali e thjeshtë quhet ajo fjali që ka vetëm një folje; fjalia është e përbërë kur ka më shumë se një folje; e di që gjymtyrët kryesore të fjalisë janë kryefjala dhe kallëzuesi; e di që kryefjala është gjymtyrë kryesore e fjalisë dhe që kallëzuesi tregon një veprim apo gjendje të kryefjalës.

Detyra 11

Fjalia është e thjeshtë kur ka vetëm një folje. Fjalia është e përbërë kur ka më shumë se një folje.

2GJLSH.1.1.5.	Niveli bazë
Cila formë e shumësit të emrit <i>dru</i> është e gabuar:	
<ul style="list-style-type: none"> a) Drutë frutorë b) Drurët e zjarrit c) Drurët e pyllit d) Drunjtë e shtrembër 	
Zgjidhja	
b)	

Detyra 12

2GJLSH.1.1.5.	Niveli bazë
Në fjalinë <i>Agroni kreu punën mirë</i> kemi fjalinë:	
<ul style="list-style-type: none"> a) e thjeshtë b) e përbërë 	
Zgjidhja	
a)	

2GJLSH.1.1.6. Ka një fond leksikor, i cili i përmbush nevojat në nivelin e mesëm të arsimit¹; bën dallimin mes leksikut letrar dhe joletrar dhe i përdor sipas situatës së krijuar; ka njohuri themelore për kuptimin e fjalëve²; njeh grupet e fjalëve: sinonimet, antonimet, homonimet; njeh metaforën si mekanizëm leksikor³. I dallon huazimet nga gjuhët e tjera

1 - Mund ta përcjellë mësimin, të lexojë lektyrën dhe prozën letrare, lexon gazeta dhe tekste të popullarizuara shkencore e të ngjashme; atë që mendon e shpreh qartë duke e përzgjedhur fjalën e duhur.

2 - E di çfarë është njëkuptimësia dhe shumëkuptimësia e fjalëve, si edhe që ekzistojnë kuptimet themelore të fjalëve dhe ato që janë të prejardhura (psh. Kuptimi bazë i fjalës kulm/çati është “pjesa e sipërme e shtëpisë)...”, kurse kuptimi i prejardhur është “shtëpia”, ajo gjë që e mbulon ndonjë hapësirë”, “ajo që mbulon ose mbron”.

3 – e di që metafora është fjalë e figurshme që paraqet një krahasim të shkurtër ose ndonjë veçori të dikujt. Emërton një send a një fenomen me emrin e një sendi a fenomenit tjetër që i ngjan atij.
Psh.: Vullnet i hekurt.

4 – dallon përdorimin e arsyetueshëm të fjalës së huaj (kur një nocion i caktuar nuk ekziston si fjalë e gjuhës vendëse) - psh. Huazimet nga fjalët e huaja.

Detyra 13

2GJLSH.1.1.6.	Niveli bazë
Çka nënkupton fjala BILANS në fjalinë e radhës: Një gjendje e tillë është <i>bilans</i> i punës së mirë të bërë me kohë.	
<ul style="list-style-type: none"> a) rezultat b) tentim c) fillim d) sukses 	
Zgjidhja	
a)	

Detyra 14

2GJLSH.1.1.6.	Niveli bazë
Cila karakteristikë i përket metaforës?	
<ul style="list-style-type: none"> a) Vë në dukje një cilësi të sendit a frymorit. b) Emërton një send a dukuri me emrin e një sendi tjetër që ngjan. c) I zmadhon sendet ose dukuritë d) Shpreh një mendim të nënkuptuar 	
Zgjidhja	
b)	

NIVELI I MESËM

2GJLSH.2.1.1. Ka njohuri më të thella për gjuhën në krahasim me nivelin bazë; Njeh njësitë, të cilat u përkasin niveleve të ndryshme të gjuhës; E njeh drejtshkrimin e gjuhës shqipe, fonetikën, morfologjinë¹, etimologjinë² etj. I njeh parimet e zhvillimit të dialogut; I kupton parimet themelore për zhvillimin e dialogut³. E kupton nocionin a aktit të të folurit⁴; I njeh nëndialektet e gjuhës shqipe⁵.

1 - Fjala është për fonetikën përkatësisht fonologjinë, (ku janë njësitë e fonemës, tingulli, rrokja) morfologjinë (morfema, fjala), sintaksën (fjala, togfjalëshi, kallëzuesi dhe fjalia komunikuese) dhe etj.

2 - e di se etimologjia është degë e gjuhësisë që studion prejardhjen e fjalëve të një gjuhe, duke u mbështetur në historinë e saj e në lidhjet me gjuhët e tjera;

3- Fjala është për këto parime: që biseda të zhvillohet ashtu që folësit ta zëvendësojnë njëri tjetrin, ashtu që në një moment flet vetëm një; që të folurit të plotësohet në mënyrë tipike me mjete jogjuhësore komunikative (gjestet, mimika, lëvizja); që të folurit spontan e shquan mëdyshja, përsëritja, me fjalët e papërfunduara e të ngjashme; që bashkëbiseduesi me sinjale të ndryshme vazhdimisht e nxit folësin të vazhdojë (këto janë të ashtuquajturat sinjale nga prapavija/përsëritja e fjalëve të folësit, pyetjet, ndërhyrjet, komentet e shkurtra etj.)

4 - Në brendi të shqiptimit të secilës shprehje qëndron ndonjë qëllim komunikues: folësi (përkatesisht autori i tekstit të shkruar) shprehjen e vet e dërgon si njoftim, pyetje, kërkesë, urdher, leje, kërkim falje, ftesë, pranim ose refuzim të ftesës, ankesë, premtim, kërcënim, falënderim, kompliment etj.

5 - E di se gjuha shqipe ndahet në dy dialekte kryesore: dialekti gegë (Shqipëria Veriore, Kosova, zona kufitare e Malit të Zi) dhe dialekti toskë (Shqipëria Jugore, një pjesë e Maqedonisë) në të cilën numërohet edhe të folurit letrar mjaft të zhvilluar të arbëreshve (Diaspora shqiptare në Itali dhe në Greqi). E di që këto dy dialekte i kanë marrë emërtimet sipas emërtimeve të shqiptarëve që jetojnë në këto zona – sipas gegëve në Veri dhe toskëve në jug të cilët i ndan lumi Shkumbin në Shqipërinë e Mesme, dhe sipas arbëreshëve në Itali dhe në Greqi.

Detyra 15

2GJLSH.2.1.1.	Niveli i mesëm
<p>Është dhënë një dialog i cili përbëhet nga tri deklarime. Para secilit dekrim shkruaj cili është akti i të folurit që folësi kreu duke shprehur atë deklaram.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Agroni: Sonte ka një shfaqje të mirë. _____ 2. Teuta: Nesër kam provim nga gjuhë angleze. _____ 3. Beni: Mirë, ndonjëherë tjetër. _____ 	
Zgjidhja	
<ol style="list-style-type: none"> 1. thirrje (hajde me mua në shfaqje) 2. refuzim i ftesës (nuk mundem) 3. pranim i refuzimit 	

Detyra 16

2GJLSH.2.1.1.	Niveli i mesëm
<p>Rretho shkronjën para fjalisë me vizë e cila tregon nocion në tekst.</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Në treg, blerësi me dorë i tregon shitësit disa dardha dhe i thotë: - Më jep 1 kg nga <u>këto</u>, ju lutem. b) Kam blerë sot dardha të kuqe. <u>Ato</u> më pëlqejnë shumë. c) Shih të lutem <u>ato</u> dardha – ty të vjen që menjëherë t'i kafshosh. 	
Zgjidhja	
b)	

Detyra 17

2GJLSH.2.1.1.	Niveli i mesëm
Si kufi natyror midis dialekteve të shqipes merret:	
<ul style="list-style-type: none"> a) Vjosa b) Semani c) Shkumbini d) Mati. 	
Zgjidhja	
c)	

Detyra 18

2GJLSH.2.1.1.	Niveli i mesëm
Etimologjia merret me:	
<ul style="list-style-type: none"> a) Me hartimin e fjalorëve b) Me shpëgimin e prejardhjes së fjalëve c) Me studimin e morfologjisë d) Me studimin e sintaksës 	
Zgjidhja	
c) Me shpëgimin e prejardhjes së fjalëve	

2GJLSH.2.1.2. I di tiparet dalluese të të dy dialekteve të gjuhës shqipe; P.sh.: në sistemin fonetik për gegërishten është karakteristike seria e zanoreve hundore kurse në toskërishte ka vetëm zanore gojore (hī-ni, rē-ja, zā-ni-gegërishte dhe hi-ri, re-ja, zē-ri- toskërishtja); toskërishtja ka “**ë**” në serinë e zanoreve të theksuara kurse gegërishtja nuk e ka, pra ajo i përgjigjet toskërishtes me **ã**; gegërishtja ka grupin nistor **vo** kurse toskërishtja ka grupin **va** (vaj, varr, vatër-toskërishtja., dhe voj, vorr, votër-gegërishtja) etj.; Në toskërishte ruhen grupet **mb, nd, ng** ndërkaq në gegërishte kanë dhënë **m, n, n**; Po ashtu e di se këto dialekte veçohen edhe nga tiparet morfologjike e leksikore; Mund t’i rirrendis etapat e zhvillimit të gjuhës letrare, të cilat janë të njohura edhe më parë;

Detyra 19

2GJLSH.2.1.2.	Niveli i mesëm
Në cilin dialekt janë shkruar këto vargje:	
<p>Pra, mallkue njai bir shqyptari, Qi ketë gjuhë të Perëndis, Trashigim, qi na la i Pari, Trashigim s’i a len ai fmis;</p> <p>(Nga vjersha <i>Gjuha shqype</i> e Gjergj Fishtës)</p> <ul style="list-style-type: none"> a) toskërishte b) gegërishte 	
Zgjidhja	
b)	

Detyra 20

2GJLSH.2.1.2.	Niveli i mesëm
Gjuha standarde shqipe është formuar:	
Mbi bazën e gegërishtes letrare Mbi bazën e toskërishtes letrare Nga shkrirja e të dy dialektee Mbi bazën e gjuhës së oborrit mbretëror	
Zgjidhja	
b)	

2GJLSH.2.1.3. Njeh aparatit e të folurit dhe mënyrën se si prodhohen tingujt; dallon tingujt sipas pikëpamjes së artikulimit; e jep përkufizimin për fonemën; bën ndarjen fonetike të të folurit dhe në një frazë apo sintagmë spikat llojin e theksit (theks logjik, emfatik apo emocional) dhe kështu në mënyrë të drejtë mund ta shqiptojë fjalën në njësitë e lartëpërmenduar; njeh mekanizmat e ndryshimit të tingujve (ndryshimet kombinatorë) siç janë: asimilimi, disimilimi, metateza, shtesat e tingujve (proteza, epenteza, epiteza), rëniet e tingujve (afereza, sinkopa, apokopa). E di çfarë janë antonimet, homonimet dhe fjalët sinonimike.

Detyra 21

2GJLSH.2.1.3.	Niveli i mesëm
Sa rrokje ka fjala:	
<i>LULISHTE</i>	
a) një b) dy c) tri 4) katër	
Zgjidhja	
c)	

Detyra 22

2GJLSH.2.1.3.	Niveli i mesëm
Në fjalinë Beni <i>kish</i> ardhur për vizitë; te fjala e nënvizuar kemi:	
a) aferezë b) sinkopë c) apokopë	
Zgjidhja	
c)	

Detyra 23

2GJLSH.2.1.3.	Niveli i mesëm
Në vargjet popullore: “Dhe djalën e parë/e kam bërë nd’arë./Vjehrra u çudit ,/burri u mahnit ”, fjalët me të zeza janë? a) Sinonime b) Homonime c) Antonime d) metonimi	
Zgjidhja	
a) Sinonime	

Detyra 24

2GJLSH.2.1.3.	Niveli i mesëm
Çiftet sinonimike: druhem/trembem, stepem/ngurroj/ janë: a) me kuptim të njëjtë b) shkencore c) me kuptim të përafërt d) me kuptim të specializuar	
Zgjidhja	
c)	

Detyra 24

2GJLSH.2.1.3.	Niveli i mesëm
Në cilin rast është theksuar drejt fjala fluturave: flutúrave flúturave fluturáve fluturavé	
Zgjidhja	
b)	

2GJLSH.2.1.4. Ka njohuri të gjera për fjalën dhe veçoritë e saj; i di pjesët e ligjëratës¹; di se forma e fjalës është fonetiko-gramatikore sepse përbëhet nga elemente fonetike e gramatikore duke e paraqitur me shembull si bie fjala: emri *vëlla-i* ka tingujt e nyjëtuar *v-ë-ll-a-i* dhe temën fjalëformuese *vëlla-* dhe mbaresën *-i*, e cila tregon gjininë, numrin, rasën e trajtën e emrit; e njeh termin morfemë; i di parashtesat dhe prapashtesat e fjalës dhe për vënien e theksit. E di ku përdoret apostrofi²

1 – e di cilës pjesë të ligjëratës i takon fjala e dhënë; di për pjesët e ndryshuara dhe të pandryshuara të ligjëratës.

2 - e di rrënjën e fjalës; e njeh fjalëformimin; i di mbaresat e fjalëve dhe vënien e theksit

Detyra 25

2GJLSH.2.1.4.	Niveli i mesëm
Trego në cilën rasë janë emrat e nënvizuar në fjalinë e mëposhtme: Çfarë do të bënte <u>Skënderbeu</u> në këtë rast? Natyrisht, ai do të bashkohej me <u>popullin</u> kundër <u>tiranëve</u> .	
Nga Autobiografia e Fan Nolit	
a) emërore b) gjinore c) dhanore d) kallëzore e) rrjedhore	
Zgjidhja	
a),d) c)	

Detyra 26

2GJLSH.2.1.4.	Niveli i mesëm
Ku është përdorur drejt apostrofi: a) Mit'hat, Et'hëm, b) T'a thashë, m'a tregoi c) Se di, mu afrua, ti dish d) T'i thuash t'u japësh, m'i dërgoi librat	
Zgjidhja	
d)	

2GJLSH.2.1.5. Gjatë procesit të ligjërimit, përdor fjalë duke i bashkuar për ta shprehur e transmetuar mendimin dhe ato (fjalë) duke hyrë në lidhje e marrëdhënie të ndryshme kuptimore e formale gramatikore krijojnë njësi të ndryshme sintaksore; di për tipat e fjalive sipas ndërtimit¹; analizon fjalitë e ndërtuara sipas modeleve të ndryshme; ka njohuri të gjera rreth togfjalëshit²; i njeh llojet e periudhave³; i di mënyrat e foljeve.

- 1- E di që gjatë procesit të ligjërimit folësi përdor herë fjali me dy gjymtyrë kryesore, herë me fjali me një gjymtyrë kryesore. psh. *Familja është shkolla e parë e jetës* (me dy gjymtyrë kryesore); *Po flasim fjalë të mira për Nitën.* (Fjali me një gjymtyrë kryesore)
- 2- E di që togfjalëshi është njësi sintaksore e formuar nga bashkimi gramatikor e kuptimor i dy ose më shumë fjalëve kuptimplota të bashkuara me lidhjen e nënrenditjes; fjalët kuptimplota nga bashkimi i të cilave formohen togfjalëshat, janë: emrat, mbiemrat, përemrat, numërorët, foljet e ndajfoljet.
- 3- E di që ekzistojnë periudha me bashkërenditje, periudha me nënrenditje dhe periudha asidentike; periudha me bashkërenditje, e formuar prej dy a më shumë fjalish, dhe periudha me nënërenditje e formuar prej dy fjalish të bashkuara me lidhëza a me pjesë lidhëse; e di edhe se periudha asidentike është e formuar prej dy a më shumë fjalish , psh. *Bëre keq, gjete keq; bëre mirë, gjete mirë.*

Detyra 27

2GJLSH.2.1.5.	Niveli i mesëm
Në fjalinë e mëpashme gjeni togfjalëshin emër + emër dhe nënvizojeni: Mos fol fjalë pa kripë. Ata dukeshin si bisha të egra. Ajo ndëresë është shumë e bukur.	
Zgjidhja	
Mos fol <i>fjalë pa kripë</i> .	

Detyra 28

2GJLSH.2.1.5.	Niveli i mesëm
Çfarë fjalie është kjo: <i>Tani pleqtë e tij pinë kafënë e mëngjesit në heshtje, ndërsa motra mbush ujë te pushi.</i> a) Fjali me bashkërenditje b) Fjali me nënrenditje	
Zgjidhja	
a)	

Detyra 29

2GJLSH.2.1.5.	Niveli i mesëm
Në fjalinë <i>Nxënësit tuaj <u>mësuakan</u> shumë fjala e nënvizuar është folje në:</i> a) mënyrën dëftore b) mënyrën lidhore c) mënyra kushtore d) mënyrën habitore e) mënyrën dëshirore f) mënyrën urdhërore	
Zgjidhja	
d)	

Detyra 30

2GJLSH.2.1.5.	Niveli i mesëm
Nënvizo togfjalëshat në fjalinë e mëposhtme <i>“Zëri i saj jehonte atë ditë në kupë të qiellit”.</i>	
Zgjidhja	
<u>zëri i saj</u> <u>jehonte atë ditë</u> <u>në kup të qiellit</u>	

2GJLSH.2.1.6. Ka fond të pasur leksikor (leksikun individual e të huaj); e di çfarë janë parashtesat dhe prapashtesat që përdoren nga gjuhët e huaja në gjuhën shqipe; fondin leksikor e shfrytëzon sipas rastit; sipas tij, gjuha është i vetmi mjet i komunikimit që shërben për ta shprehur mendimin e tij, por edhe përvojën individuale dhe kështu e pasuron edhe më tepër fjalorin; e di çfarë do të thotë historizëm¹, arkaizëm² dhe neologjizëm³; dallon shtresat leksikore; njeh metaforën dhe metoniminë² si mekanizma leksikor. Di për antonimet, sinonimet dhe homonimet.

1 – e di që historizëm quhet parimi i studimit, sipas të cilit sendet, ngjarjet, dukuritë etj. vështrohen e vlerësohen në zhvillimin e tyre historik të pandërprerë e tërësor dhe në lidhje me kushtet konkrete; parim metodologjik historik. Prirje për të dhënë sa më shumë elemente nga e kaluara në një vepër artistike ose shkencore; psh. Ka rënë në historizëm.

2 – e di që arkaizëm quhen ato fjalë të vjetëruara që sot, nuk përdoren më gjatë të shkruarit ose gjatë të folurit,

3 – e di që neologjizma quhen fjalët ose shprehjet që kanë hyrë rishtazi në gjuhë për të shënuar një send a një dukuri të re dhe që ende ndihet si e tillë.

Detyra 31

2GJLSH.2.1.6.	Niveli i mesëm
<p>Çka do të thotë kur themi se gjuha është <i>prodhuese</i> ? Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.</p> <p>a) Me anë të gjuhës barten njohuri mes brezash. b) Me ndihmën e gjuhës e në pajtim me kërkesat e saj, njeriu mundet gjithnjë të krijoj thënie të reja. c) Me gjuhë mund të flitet edhe për të kaluarën, edhe për të ardhmen, vendet e largëta, gjërat e paqena. d) Me kombinimin e njësive të rangut të ulët edukohen njësitë e rangut më të lartë.</p>	
Zgjidhja	
b)	

Detyra 32

2GJLSH.2.1.6.	Niveli i mesëm
<p>Çka është fjala e nënvizuar në fjalinë e mëposhtme:</p> <p><u>Akëxhinjtë</u> po çonin kuajt për të pirë ujë te lumi i vogël.</p> <p>Nga Ismail Kadare</p> <p>arkaizëm historizëm neologjizëm</p>	
Zgjidhja	
b)	

Detyra 33

2GJLSH.2.1.5. Në vargjet “Se të qante kur të qeshnin , se të veshte kur të zhveshnin ”, fjalët me të zeza janë: a) sinonime b) antonime c) homonime d) metonime	Niveli i mesëm
Zgjidhja	
b)	

NIVELI I PËRPARUAR

2GJLSH.3.1.1. E di kupton se ekziston lidhja e ngushtë midis gjuhës dhe mendimit; e di nocionin e kategorizimit¹; di çfarë janë maksimat e bashkëbisedimit (cilësia, madhësia, përshtatshmëria dhe mënyrat)²; e kupton nocionin e aktualizimit informativ të fjalisë dhe e di se si ajo arrihet; e ka të qartë nocionin e kohezionit tekstual³

1 - Këtu është fjala për gjuhën, si pasqyrim i përvojës së njeriut, ndërmjetëson midis realitetit dhe mendimit të njeriut. Pra, kategorizimi është rreshtim i dukurive nga bota e jashtme në grupe, për nevoja të mendimit dhe të kodimit gjuhësor. Kategorizimi drejtpërsëdrejti është i rëndësishëm për gjuhë: Saherë që për ndonjë dukuri e përdorim të njëjtin emërtim, ne në fakt i rreshtojmë bashkë, në të njëjtën kategori (karriga e dentistit dallohet mjaft nga karriget e zakonshme, por ne e dallojmë si të ngjashme dhe e emërtojmë me fjalë të njëjtë – *karrige*).

2 - Maksimat e bashkëbisedimit janë shprehje të të ashtuquajtura të parimit bashkëpunues – supozohet që bashkëbiseduesit gjatë komunikimit ndërsjelltazi bashkëpunojnë; maksimat janë rregulla në heshtje të cilat ata, pavarësisht dhe automatikisht respektohen gjatë komunikimit (jo vetëm në mënyrë verbale por edhe joverbale) . Këto janë: (1) maksima e kuantitetit: Ji i informuar aq sa është kjo e nevojshme (as më pak as më shumë); (2) maksima e cilësisë: thuaje atë që mendon se është e vërtetë; (3) maksima e asaj që është e rëndësishme: thuaje atë që është e rëndësishme; (4) maksima e mënyrës: fol shkurt dhe qartë.

Detyra 34

2GJLSH.3.1.1.	Niveli i përparuar
Shkruaj cilin parim të bisedës bashkëbiseduesi nuk e ka respektuar duke dhënë më 24 maj në orën 3 e 5 minuta, përgjigjet në pyetjen: Cila datë është sot?	
Njëzet e diçka. _____ Saktë ora 3 e 5 minuta. _____ 15 maj. _____	
Zgjidhja	
Parimi i kuantitetit Parimi i përshtatshmërisë Parimi i cilësisë	

Detyra 35

2GJLSH.3.1.1.	Niveli i avansuar
Cila nga fjalitë e dhëna jep përgjigje në pyetjen: <i>Arta kur do ta blejë gazetën?</i>	
Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.	
<ul style="list-style-type: none"> a) Kur do të kthehet nga puna, Arta do ta blejë gazetën. b) Arta, kur do të kthehet nga puna do ta blejë gazetën. c) Arta do ta blejë gazetën kur do të kthehet nga puna. d) Arta do ta blejë gazetën, kur do të kthehet nga puna. 	
Zgjidhja	
d)	

2GJLSH.3.1.2. Gjatë ndarjes së fjalëve në rrokje, përdor mjetet fonetike për ndarjen e saj (rrokjes) si: gjatësinë dhe forcën.

Detyra 36

2GJLSH.3.1.2.	Niveli i avansuar
Vendos theksin në fjalët e mëposhtme:	
LUMË FLUTURA MUZE	
Zgjidhja	
lúmë (theks parafundor) flútura (theks tejfundor) muzé (theks fundor)	

2GJLSH.3.1.3. Ka njohuri për morfologjinë në kuptimin e gjerë të fjalës¹, në të cilën jepet përshkrimi i kategorive gramatikore të shqipes; e ndan apo e zbërthen fjalën në morfema duke e dalluar morfemën rrënjë, parashtesore dhe prapeshtesore.

- 1- Këto njohuri të hollësishme e nënkuptojnë veçantinë e lakimit të emrave dhe veçantinë e lakimit të fjalëve tjera emërore, veçantinë e krahasimit të mbiemrave, zgjedhimin e foljeve dhe etj.

Detyra 37

2GJLSH.3.1.3.	Niveli i avansuar
Duke e ndarë në pjesë përbërese fjalën përfundimtare gjej rrënjën e kësaj fjale	
<ul style="list-style-type: none"> a) për b) fund c) im d) tar 	
Zgjidhja	
b)	

2GJLSH.3.1.4. Ka njohuri më të gjera për përdorimin e rasave dhe të formave foljore¹; mund t'i analizojë fjalitë nga pikëpamja morfologjike (duke i gjetur pjesët e ligjëratës); dallon kryefjalën, kallëzuesin dhe gjymtyrët e veçuara² duke bërë analizën sintaksore.

1 – i njeh kuptimet kryesore përkatësisht përdorimin e rasave. I njeh edhe kuptimet e tjera të kohëve të foljeve dhe të mënyrave.

2 – e di që gjymtyrë të veçuara janë ato gjymtyrë të dyta që dallohen nga gjymtyrët e tjera me veçori kuptimore, stilistike e intonacionore, duke fituar me këtë rast në fjali një mëvetësi më të madhe sintaksore; gjymtyrët e veçuara e bëjnë stilin më të ngjeshur, me më pak mjete gjuhësore jepet një informim më i mirë e më i plotë, prandaj janë një mjet i rëndësishëm stilistik.

Detyra 38

2GJLSH.3.1.4.	Niveli i avansuar
Në fjalinë: <i>Ata janë duke punuar tokën</i> ; trego cilës formë të pashtjelluar të foljes i përkasin fjalët me vizë:	
<ul style="list-style-type: none"> a) pjesore b) paskajore c) përcjellore d) mohore 	
Zgjidhja	
c)	

Detyra 39

2GJLSH.3.1.4.	Niveli i avansuar
Trego rasën e fjalës së nënvzuar në fjalinë e dhënë:	
Shkoni, pra i zini pritrat e mos luani (<i>prej</i>) <u>vendit</u> fare, qëndroni si burra të fortë, gjuani si gjahtarë të mirë, armët mos i nxini.	
Nga Konstandin Kristoforidhi	
<ul style="list-style-type: none"> a) emërore b) gjinore c) dhanore d) kallëzore e) rrjedhore 	
Zgjidhja	
e)	

Detyra 40

2GJLSH.3.1.4.	Niveli i avansuar
Në fjalinë <i>Agroni kreu punën mirë</i> fjala me vizë është:	
a) kryefjalë b) kallëzuesor c) kundrinor d) rrethanor	
Zgjidhja	
c)	

Detyra 30

2GJLSH.3.1.4.	Niveli i avansuar
Në këtë fjali nënvizo gjymtyrën e veçuar: <i>Halili, i rrëmbyer nga bukuria e Tanushës, i hipi kalit dhe u nis drejt shtëpisë së saj. Dielli ndrit shumë e ngroh pak.</i>	
Nga Mitrush Kuteli	
Zgjidhja	
<i>Halili, i rrëmbyer nga bukuria e Tanushës, i hipi kalit dhe u nis drejt shtëpisë së saj.</i>	

2.2 Fusha: LETËRSI

Letërsia është lloj i artit që e pasqyron jetën nëpërmjet figurave artistike të krijuara me anën e fjalës; veprat e shkruara në këtë lloj arti janë (proza, poezia, drama). Pra, letërsia është tërësia e veprave shkencore, artistike e një populli ose e tërë njerëzimit, që janë botuar gjatë një periudhe të caktuar ose gjatë gjithë kohëve; Letërsia ua mundëson nxënësve që ta kuptojnë rëndësinë që ka ajo dhe nevojën që të lexojnë, kënaqësinë e leximit dhe të shprehurit letrar. Duke lexuar tekste nxënësit e pasurojnë përvojën e vet dhe informohen për letërsinë dhe traditën e gjuhës shqipe si pjesë e veçantë e identitetit kombëtar. Letërsia ndikon që veçanërisht nxënësit ta zhvillojnë fantazinë dhe kriteret estetike të vlerësimit se si e përjetojnë letërsinë si burim i njohurive, përvojës dhe vlerave të njerëzimit sepse letërsia në të gjitha gjuhët e botës jep mesazhe dhe ide përgjithësisht të pranueshme për të gjithë.

Pra, fusha e Letërsisë dhe e krijimtarisë bazohet në lexim dhe perceptimin e tekstit letrar që është produkt i të kuptuarit gjuhësor dhe të menduarit dhe veçanërisht të kuptuarit e botës dhe realitetit.

Duke lexuar zhvillohen fazat kognitive dhe gjuhësore të zhvillimit të nxënësit dhe e nxit realizimin e tërë potencialit të tij me të cilin rast përjetim vendimtar është gëzimi dhe sukcesi në mësimin e gjuhës, letërsisë dhe kulturës kombëtare.

Duke lexuar një tekst letrar krijohet bashkëmarrëdhënia me tekstet e tjera, krahasohet dhe kundërshtohet dhe në këtë mënyrë krijohet kuptimi dhe argëtimi, si edhe nxiten reflekse të ndryshme të fëmijët dhe të rinjtë. Veçanërisht theksohet inicimi i leximit dhe përjetimit, krijohen shprehitë e të lexuarit dhe shprehia e kulturës për lexim. Prandaj është shumë me rëndësi që nxënësi të nxitet që të lexojë tekste letrare sipas zgjedhjes së vet dhe ta arsyetojë pse pikërisht ka bërë një zgjedhje të tillë. Duke zhvilluar shkathtësitë e interpretimit, e lidh përvojën e vet dhe përvojën e fiksonit letrar. E shton krijimtarinë në pajtim me mundësitë dhe interesimet e nxënësve dhe të të rinjve,

Duke lexuar tekste nxënësi krijon shprehje leximi dhe bëhet person më i suksesshëm dhe më i shoqërueshëm në kontakt me të rinjtë e tjerë dhe në këtë mënyrë i zgjeron edhe më shumë përvojat e veta dhe fiton njohuri nga njerëzit e tjerë dhe kulturat e tjera.

- lexon në mënyrë të pavarur, i interpreton tekstet e letërsisë shqipe dhe botërore në bazë të përvojës së vet të leximit dhe fiton njohuri për letërsinë dhe krijon mendim kritik dhe shije letrare;
- zbulon mënyra të ndryshme të leximit duke e zhvilluar përvojën e leximit e cila i formon dhe krijon përvojat vetjake dhe krijon perspektiva të reja, e nxit zhvillimin e imagjinatës dhe refleksin për botën, veten dhe të tjerët;

Në burime të ndryshme gjen përmbajtje dhe informacione për të cilat mendon në mënyrë kritike, e vlerëson sigurinë dhe përfitimin e tyre, e dallon kontekstin dhe qëllimin e autorit dhe e aplikon të shkruarit në mënyrë të shumëfishtë, në mënyrë të pavarur i zgjidh problemet dhe merr vendime.

- E zhvillon identitetin e vet gjuhësor dhe kulturor duke përdorur një ose më shumë idioma të efektshme gjuhësore dhe i respekton bashkësitë e ndryshme gjuhësore dhe kulturore si edhe vlerat e tyre.
- E kupton rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë dhe kulturës letrare;
- E zhvillon përvojën për lexim dhe mëson teknikën e leximit

Duke e fituar identitetin kulturor i cili i kthehet botës si kulturë dhe njeriut si kulturë, interpretimi dhe leximi i veprës letrare ia mundëson nxënësit që të shqyrtojë identitetin e vet kombëtar në shoqëri bashkëkohore shumëkulturore, si edhe të zhvillojë humanizmin bashkëkohor dhe kështu t'i tejkalojë paragjykimet e ndryshme gjinore, të racës, etnike dhe kulturore.

2.2.2. Komentet me standarde në fushën e Letërsisë.

STANDARDI 1. Pasqyrimi përmbledhës lidhur me standardin

Me këtë standard përkufizohet korniza, shtresimi dhe ndërlikueshmëria e leximit kritik dhe interpretimit të veprës

Niveli bazë

2GJLSH.1.2.1. Njih autorët nga programi obligativ shkollor dhe i vendos në kontekst të opusit krijues dhe në kontekst letrar dhe historik.

Me shkallëzimin e kërkesës bazë të shprehur me standard, pritet që nxënësi do të dijë dhe do të jetë i aftë në mënyrë të saktë ta caktojë autorin e veprës, së pari në bazë të titullit të saj, ta parafranojë përmbajtjen, fragmentin si edhe të theksojë veprat të cilat i ka shkruar një autor i caktuar dhe të cilat janë përfshirë në pjesën e mësimave që janë të obliguara me plan dhe program. Përveç këtij kontekstualizimi, nxënësi duhet të jetë i sigurt që ta caktojë cilës epoke në zhvillimin e letërsisë i takon kjo vepër dhe ky autor.

Niveli i mesëm:

2GJLSH.2.2.1. E interpreton tekstin letrar në faktorë të vet integruar (përjetimet, konteksti, përbërja, personazhet, format e tregimit, aspektet gjuhësore dhe stilistike.

Në nivelin e mesëm nxënësi në bazë të faktorëve më parë të theksuar integruar të veprës, me ndihmën e arsimit, bashkë me shembujt e theksuar, e interpreton veprën në mënyrë të sigurt ashtu që e paraqet përjetimin e vet lexues, i cakton temat parësore dhe dytësore, i vëren elementet e

ndërthurjes së veprës si edhe procedurat e karakterizimit të personazheve kryesorë dhe dytësorë, i përcakton llojet e rrëfimit dhe përshkrimit, mjetet shprehëse gjuhësore dhe stilistike...

Niveli i përparuar

2GJLSH.3.2.1. Lexon, e përjeton dhe e interpreton në mënyrë të pavarur veprën letrare artistike dhe letrare shkencore nga programi i obligueshëm shkollor, si edhe testet plotësuese (të zgjedhura) dhe fakultative letrare-artistike dhe letrare dhe shkencore; gjatë interpretimit me siguri i përdor njohuritë e fituara për opusin krijues të autorit dhe për kontekstin letrar dhe historik.

STANDARDI 2. Pasqyrimi përmbledhës lidhur me standardin

Standardet e theksuara i rrisin njohuritë e nxënësit nga fusha e terminologjisë letrare dhe teorike dhe aftësitë e tij që t'i aplikojë në situata adekuate.

Niveli bazë

2GJLSH.1.2.2. E njeh terminologjinë letrare dhe teorike dhe i vë në lidhje funksionale me shembuj nga tekstet e letërsisë letrare² dhe joletrare³ të përcaktuara me program.

Në nivelin bazë nxënësi duhet që në bazë të shembujve t'i emërojë dukuritë letrare dhe teorike që janë ilustruar me shembuj, si edhe që për secilin term të theksojë nga një shembull bazë, më të thjeshtë dhe më paradigmatik. Kjo kërkesë ka të bëjë në radhë të parë me shembuj më të thjeshtë, përkatësisht me shembujt e atyre nocioneve themelore letrare dhe teorike të theksuara në pjesën e obliguar me program shkollor.

Niveli i mesëm

2GJLSH.2.2.2. E njeh terminologjinë letrare dhe teorike dhe njohuritë letrare teorike dhe i përdor në mënyrë adekuate në interpretimin e veprës letrare të përcaktuar me program.

Në nivel të mesëm kjo kërkesë ndërlikohet edhe më shumë me vetë faktin se nga nxënësi pritet që me rastin e interpretimit të veprës do të dijë që (1) në mënyrë të duhur t'i emërojë faktorët letrarë dhe teorikë të interpretimit të nocioneve të cilat i takojnë programit të obligueshëm shkollorë dhe që (2) do të aplikojë njohurinë e vet bazë lidhur me nocionin letrar dhe teorik me rastin e analizës së veprës që është e përcaktuar me plan dhe program shkollor.

Në nivel të mesëm një sërë nocionesh ose dukurish për nivelin bazë mbeten por që niveli i kërkesës shtohet për një shkallë. Gjithashtu shtohen këto elemente: teoria e letërsisë, historia e letërsisë dhe kritika letrare;

Niveli i përparuar

2GJLSH.3.2.2. E mbizotëron terminologjinë letrare dhe teorike dhe njohuritë teorike i aplikon në mënyrë adekuate në interpretimin e veprës letrare artistike dhe letrare shkencore të cilat janë paraparë me program të shkollës dhe me veprat e tjera të këtij lloji të gjinive të ndryshme, jashtë programit shkollor.

² Tekset letrare i nënkuptojnë tekstet letrare artistike dhe ato letrare shkencore.

³ Me tekste joletrare nënkuptohen tekstet nga shkenca për gjuhën dhe shkenca për letërsi, tekstet e popullarizuara shkencore nga këto fusha dhe, sipas nevojës, tekstet nga mediat dhe nga burimet e tjera të përshtatshme për përpunimin e lëndës Gjuhë dhe Letërsi shqipe.

Niveli i përparuar e nënkupton pavarësinë e nxënësit në përdorimin e terminologjisë letrare dhe teorike dhe në emërimin adekuat të faktorëve integruar të interpretimit të veprës letrare, dhe këtë jo vetëm të atyre që janë të obligueshme në pjesën e programit shkollor, por edhe në pjesën të cilën e ka zgjedhur vetë si edhe kur bëhet fjalë për veprat të cilat nxënësi i zgjedh vetë jashtë programit shkollor.

STANDARDI 3. Pasqyra e përgjithshme lidhur me standardin

Njohja dhe përdorimi i metodologjisë letrare dhe teorike dhe letrare shkencore është bazë për ta kuptuar letërsinë. Me këtë përparohet të kuptuarit shkencor të letërsisë dhe në mënyrë adekuate metodologjike bëhet analiza shkencore dhe interpretohet vepra letrare (pjesët përbërëse të poetikës së veprës letrare), zë pozitë brenda historisë së letërsisë dhe kulturës, në mënyrë sintetike bashkohet me disiplinat e tjera humaniste. Përdorimi adekuat i metodave teorike dhe shkencore në mirëkuptimin e letërsisë vetëm e thellon të kuptuarit e saj dhe e ofron aparaturën për t'i kuptuar edhe disiplinat e tjera humaniste.

Niveli bazë

2GJLSH.1.2.3. Në interpretimin e veprës letrare artistike dhe letrare shkencore i dallon metodat e trajtimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Nxënësi njihet me metodologjitë themelore të interpretimit të letërsisë.
Trajtimi i jashtëm, (biografizmi, historizmi, të kuptuarit shoqëror të letërsisë).
Trajtimi i brendshëm

- formalizmi rus⁴ (tema, motivi, fabula, sizhea, procedura, personazhi, heroi, gjinitë).
- naratologjia (rrëfimi në vetën e tretë, rrëfimi i autorit, rrëfimi në vetën e parë)

Strukturalizmi/semiotika (i njeh veçoritë themelore strukturore të veprës letrare),
Komparative (është njoftuar me raportin krahasues - literatura kombëtare, botërore).

Niveli i mesëm

2GJLSH.2.2.3. I dallon metodat e trajtimit të brendshëm dhe të jashtëm në interpretimin e veprës letrare artistike dhe letrare shkencore dhe i aplikon në mënyrë adekuate gjatë të kuptuarit dhe interpretimit të këtyre llojeve të veprave.

Nxënësi i dallon dhe i aplikon në mënyrë adekuate metodologjitë themelore të interpretimit të letërsisë.

Trajtimi i jashtëm (biografizmi, historizmi, të kuptuarit social të shoqërisë).

Trajtim i brendshëm:

- formalizmi (tema, motivi, fabula, procedura, personazhi/heroi, gjinitë...).

Naratologjia (instancat tregimtare (rrëfimi në vetën e tretë/rrëfimi i autorit, rrëfimi në vetën e parë (monologu i brendshëm, rrjedha e vetëdijes) pikëpamja (psikologjike, hapësinore).

Analiza poetike (elementet e konstitumit të veprës letrare (nga naracioni, struktura, formimi i personazheve, struktura e vargut, strofa, vjersha...),

⁴ Orientim metodologjik në studimin e letërsisë në Rusi 1915-1928 (Fjalor i termave letrare).

Komparativistika (krahasimi i veprave letrare sipas epikave, literatura kombëtare – botërore, sociale dhe rrethanat biografike të autorit dhe veprës).

Niveli i përparuar

2GJLSH.3.2.3. Në procesin e interpretimit të veprës letrare artistike dhe letrare shkencore, zgjedh, aplikon dhe kombinon metodat adekuate të trajtimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Nxënësi në mënyrë të duhur i përdor dhe i kombinon metodologjitë e interpretimit të veprës letrare.

Trajtimi i jashtëm (biografizmi, historizmi, të kuptuarit social të shoqërisë).

Trajtim i brendshëm:

Formalizmi rus (tema, motivi, fabula, personazhi/heroit, gjinitë...).

Naratologjia (shkalla prozatore (rrëfimi në vetën e tretë/rrëfimi i autorit, rrëfimi në vetën e parë (monologu i brendshëm, rrjedha e vetëdijes) fokalizimi, (zero, i brendshëm, i jashtëm), këndvështrimi (hapësinor-kohor-ideologjik, psikologjik, frazeologjik);

Analiza poetike (formimi i veprës letrare, elementet e konstituimit të veprës letrare (nga naracioni, struktura, karakterizimi personazheve, struktura e vargut, strofa, vjershat...).

Komparativistika (radhitja e veprave letrare sipas epikave, literatura e vendit/botërore) sociale dhe rrethanat biografike të autorit dhe të veprës, lidhjet intertekstuale dhe kulturore.

STANDARDI 4. Pasqyrë e përgjithshme lidhur me standardin

Të dalluarit e veçorive themelore poetike, gjuhësore dhe estetike të teksteve letrare dhe artistike e mundëson interpretimin e tyre analitik.

Vlerësimi dhe përshkrimi i veçorive strukturore të veprës letrare, ndërlikueshmërisë së saj dhe identitetit të gjinisë lidhet me narativin dhe me elementet stilistike nga të cilat është formuar vepra, dhe vetvetiu mundësohet që të dallohen të gjitha funksionet formëformuese të krijimit poetik të veprës letrare dhe mënyrës së formimit të kuptimit të saj.

Niveli bazë

2GJLSH.1.2.4. I vëren dhe me shembuj i argumenton veçoritë themelore, poetike, gjuhësore, estetike dhe strukturore të veprës letrare nga lektyra e obliguar shkollore.

- i dallon veçoritë themelore poetike të veprës letrare (veçoritë e gjinisë, zhanret, llojet, narativin, veçoritë e karakterit/heroit, personazheve, kompozimin letrar dhe elementet stilistike).

- i dallon veçoritë themelore strukturore dhe estetike të teksteve letrare

- e dallon se lëndë bazë e letërsisë është gjuha, stilet funksionale.

Niveli i mesëm

2GJLSH. 2.2.4. I vëren dhe i arsyeton veçoritë poetike, gjuhësore, estetike dhe strukturore të veprave letrare dhe të veprave letrare shkencore në kuadër të lektyrës shkollore; vlerëson a është më i ndërlikuar teksti letrar dhe shkencor (autobiografia, biografia, memualet, ditari, letra, përshtypjet nga udhëtimi) dhe etj.

- di të caktojë veçoritë poetike të veprës letrare dhe e cakton vendin e tyre dhe rolin në vepër letrare (veçoritë e zhanrit, gjinit, llojet).

Di të caktojë veçoritë strukturore dhe estetike të teksteve letrare dhe i cakton kuptimet dhe vlerat e tyre.

E dallon që lëndë bazë e letërsisë është gjuha, si edhe vendi i veprës joartistike (gjuha, vepra, dhe e analizon se si kjo lëndë letrare formohet në vepër të veçantë letrare.

Niveli i përparuar

2GJLSH.3.2.4. E vëren dhe i interpreton veçoritë poetike, gjuhësore, estetike dhe strukturore të teksteve letrare-artistike dhe teksteve letrare shkencore në kuadër të lektyrës shkollore dhe jashtë programit shkollor; vlerëson dhe krahason procedurat e stileve në llojet e theksuara të teksteve.

I interpreton veçoritë poetike të veprës letrare dhe e cakton vendin dhe rolin e tyre në vepër letrare.

I interpreton veçoritë strukturore dhe estetike në tekste letrare dhe i cakton kuptimet dhe vlerat e tyre.

E kupton që lëndë bazë e letërsisë është gjuha...

E kupton se edhe veprat e tjera letrare, artistike, dhe realizimet kulturore të lëndës për vepër letrare, dhe analizon se si ky tekst letrar formohet në një vepër të veçantë letrare.

STANARDI 5. *Pasqyrimi i përgjithshëm lidhur me standardin*

Të kuptuarit e veprës letrare si një nga diskurset e shumta shoqërore. Duke e krahasuar letërsinë me praktikat e tjera diskurzive, kuptohet pikëtakimi i letërsisë me diskurset e tjera (narrativi, sajimi, formimi estetik, poetik dhe i zhanrit të diskurit joartistik...) dhe këto njohuri përdoren në interpretimin e veprës penale. Vërehet dhe interpretohet asimilimi i diskursit joletrar (atij juridik, historiografik, psikologjik. ...) dhe vetvetiu kuptohet roli i tyre në poetikën e veprës letrare.

Niveli bazë

2GJLSH.1.2.5. Vërehen veçoritë themelore të letërsisë si diskurs dhe dallohet në krahasim me diskurset e tjera shoqërore.

- Dallohen veçoritë e diskursit letrar (narrativi, identitetit estetik dhe poetik, pikëpamja kritike ndaj shoqërisë, fikcioni...) në krahasim me diskurset e tjera.

- Diskursi letrar ndaj atij shkencor (historia, psikologjia, filozofia, shkencat ekzakte...), diskursi administrativ, i gazetarisë/diskursi i mediave, politik, kërkimor, letrar dhe historik...

Vërehen karakteristika:

Letërsia	Diskurset e tjera
Ritmi/melodia	mungesa e ritmit/melodisë
Subjektiviteti	objektiviteti
Mungesa e logjikës	logjika
Figuracioni i narrativit	“narrativi jofigurativ”
Simulimi i diskurseve të tjera në vepër	orientimi për diskurs vetjak
në mënyrë asociative	induktive/deduktive

Niveli i mesëm

2GJLSH.2.2.5. I arsyeton elementet e letërsisë si diskurs në krahasim me diskurset e tjera shoqërore (psh., prania/mungesa e tregimit, fokusi tregimtar, statusi historik dhe fiktiv etj.).

- i dallon veçoritë e diskursit letrar

- diskursi letrar sipas diskursit shkencor (historia, psikologjia, filozofia, shkencat ekzakte...).
- kurse diskursi administrativ, i gazetarisë/mediave, politik, kërkimor, letrar dhe teorik
- E përshkruan kuptimin dhe funksionin e diskurseve të tjera në diskurs letrar
- I krahason dhe i kupton veçoritë:

Letërsia

Diskurset e tjera

Gjuhën e figurshme	analitizmin/racionalitetin
Ritmin/melodinë	mungesën e ritmit/melodisë
Subjektivitetin	objektivitetin
Mungesën e logjikës	logjikën etj.
Figurativitet i naracionit	“naracioni jo i figurshëm”
Simulimi i diskurseve të tjera në vepër	orientimi për diskurs vetjak
në mënyrë asociative	induktive/deduktive

Niveli i përparuar

2GJLSH.2.3.5. I kupton elementet themelore të letërsisë si diskurs

- Dallon veçoritë e diskursit letrar (narativitetin, identitetin estetik-poetik, pikëpamjen kritike ndaj shoqërisë, sajimin...) në krahasim me diskurset e tjera.
- Diskursi letrar ndaj diskurit shkencor (historia, psikologjia filozofia, shkencat ekzakte. ...), diskursi administrativ, i gazetarisë/mediave, politik, kërkimor, letrar dhe teorik.
- E përshkruan kuptimin dhe funksionin e diskurseve të tjera në diskurs letrar

Krahaso:

Gjuhën e figurshme	analitizmin/racionalitetin
Ritmin/melodinë	mungesën e ritmit/melodisë
Subjektivitetin	objektivitetin
Mungesën e logjikës	logjikën etj.
Figurativitet i naracionit	“naracioni jo i figurshëm”
Simulimi i diskurseve të tjera në vepër	orientimi për diskurs vetjak
në mënyrë asociative	induktive/deduktive

STANDARDI 6. Pasqyrimi i përgjithshëm lidhur me standardin

Ky standard do të duhej të sigurojë kontestualizimin kulturor historik, letrar, teorik, poetik, estetik, filologjik, filozofik të studimit të një vepre të caktuar dhe autorit që të kuptohen më mirë faktorët parësorë dhe dytësorë të analizës dhe që të zotërohen më lehtë brenda kërkesës që janë dhënë me të.

NIVELI BAZË

2GJLSH.1.2.6. Nxënësi duhet të dallojë periudhat themelore letrare dhe teorike në zhvillimin e formacionit letrar në kuadër të letërsisë botërore dhe letërsisë shqipe, si edhe të kuptojë që autori dhe vepra e tij e kontekstualizimit brenda formacionit letrar historik dhe letrar stilistik duke i theksuar veçoritë themelore dhe përfaqësuese.

NIVELI I MESËM

2GJLSH.2.2.6. Me rastin e interpretimit të veprës letrare artistike dhe letrare shkencore nga programi shkollor aplikohen njohuritë për veçoritë themelore letrare historike dhe poetike të epokave të stilit, drejtimeve dhe formacioneve në zhvillimin e letërsisë shqipe dhe botërore.

Niveli i përparuar

2GJLSH.3.2.6. Me rastin e interpretimit dhe vlerësimit të veprës letrare artistike dhe letrare shkencore aplikohen dhe krahasohen veçoritë letrare historike dhe poetike të epokave të stileve, drejtimeve dhe formacioneve në zhvillimin e letërsisë shqipe dhe të letërsisë botërore.

Nxënësi e pranon pasurinë e formacioneve të stileve, drejtimeve dhe shkollave me rastin e interpretimit të një vepre të caktuar letrare.

STANDARDI 7. Pasqyrimi i përgjithshëm lidhur me standardin

Të kuptuarit e problemeve bazë të cilat i nxit vepra letrare: individual (psikologjik), shoqëror (vendi i individit në shoqëri), historik dhe të ngjashme.

Niveli bazë

2GJLSH.1.2.7. Analizon problemet e veçuara në veprën letrare dhe di t'i argumentojë me një tekst parësor.

- E veçon (me ndihmën e profesorit) një problem themelor që e inicon vepra letrare.
- Argumenton se e ka kuptuar problemin e thekson nga teksti parësor i veprës letrare (raporti midis heronjve, raporti hero-shoqëri, struktura e subjektit lirik, rrethanat historike, ekonomike...), i thekson pjesët e veprës letrare që janë të rëndësishme për ta kuptuar problemin.

Niveli i mesëm

2GJLSH.2.2.7. Në mënyrë të pavarur i vëren dhe i analizon problemet në vepër letrare dhe di t'i argumentojë qëndrimet e veta në bazë të tekstit parësor.

Niveli i përparuar

2GJLSH.3.2.7. Në mënyrë të pavarur i interpreton problemet dhe idetë në vepër letrare dhe di t'i argumentojë qëndrimet e veta në bazë të tekstit parësor dhe kontekstit letrar dhe filologjik.

- Në mënyrë të pavarur i vëren problemet të cilat i nxit një vepër letrare.
- E argumenton se e ka kuptuar problemin dhe këtë e thekson nga teksti parësor i veprës (raportin midis heronjve, raportin hero - shoqëri, strukturën e subjektit lirik, strukturën historike, ekonomike, rrethanat. ...), thekson pjesët e veprës letrare që janë të rëndësishme që të kuptohet problemi.

STANDARADI 8. Pasqyrim i përgjithshëm lidhur me standardin

Me këtë standard ekzaminohen mënyrat dhe suksesi i nxënësit se si e përdor literaturën dytësore në kuadër të zotërimit të programit shkollor të kësaj lënde.

Niveli bazë

2.GJ.SH.1.2.3. E përdor literaturën e rekomanduar (letrare teorike, kritike, vetëpoetike, teorike) dhe e vë në lidhje me tekstet letrare të përcaktuara me program.

Aspektet e aplikimit të këtij standardi në nivel bazë janë: (1) të veçuarit e informacioneve kryesore; (2) aplikimi i strategjive themelore të lexuesit; (3) përdorimi i përmbajtjes nga literatura dytësore për zotërimin më të lehtë të njësisë mësimore.

Niveli i mesëm

2GJLSH.2.2.8. Në mënyrë aktive e përdor literaturën e rekomanduar dhe literaturën e gjerë dytësore (letrare dhe historike, kritike, vetëpoetike, teorike) në interpretimin e veprës letrare artistike dhe letrare shkencore të përcaktuar me program. Aspektet e aplikimit të këtij standardi në nivel të mesëm janë: (1) e vëren rëndësinë e literaturës dytësore për grumbullimin e informacioneve që mund t'i bartë edhe në situata të tjera lidhur me zgjidhjen e problemit; (2) konstatimi dhe kultivimi i shprehive për përdorimin e enciklopedive, leksikonëve, fjalorëve; (3) aplikimi aktiv dhe i pavarur i njohurive të fituara nga literatura dytësore me rastin e interpretimit të veprës nga programi shkollor.

Niveli i përparuar

2GJLSH.3.2.8. Në interpretimin e veprës letrare e përdor në mënyrë kritike literaturën e rekomanduar dhe të zgjedhur dytësore (letrare, historike, kritike, vetëpoetike, teorike).

Të gjitha aspektet e theksuara deri më tani të këtij standardi aplikohen edhe në këtë nivel: (1) ngritja si e shkallës së ndërlukshmërisë dhe gjatësisë së tekstit që interpretohet, ashtu edhe e literaturës dytësore e cila përdoret me rastin e interpretimit të saj; (2) insisitmi për trajtim kritik i literaturës dytësore, dhe (3) përdorimi si i literaturës së rekomanduar ashtu edhe i literaturës të cilën e zgjedh vetë, për cilësi më të mirë dhe mirëkuptim më të plotë të temës nga programi mësimor ose ushtrimi i detyrës lidhur me faktin se sa e ka kuptuar dhe interpretuar veprën.

STANDARDI 9. Pasqyrimi i përgjithshëm lidhur me standardin

Formimi i shprehive të leximit, të kuptuarit e rolit të leximit dhe interpretimit të veprës letrare. Studimi krahasues i letërsisë amë, si edhe të kuptuarit e mënyrës së konstituimit të veprës letrare përmes leximit, e vë veprën letrare brenda zinxhirit të pranimit.

Niveli bazë

2GJLSH.1.2.9. Në bazë të veprës së letërsisë shqipe dhe asaj botërore, formohet shprehia e leximit por edhe njohuritë. Nxënësi e mëson rolin e leximit dhe të interpretimit të veprës letrare në ndërtimin e identitetit gjuhësor, letrar, kulturor dhe kombëtar.

- e dallon veprën letrare si krijim estetik dhe si dokument kulturor – historik;
- e kupton rolin dhe vendin e leximit të letërsisë në formimin e identitetit personal kulturor (kombëtar dhe shoqëror).
- e kupton kritikën letrare të shoqërisë në favor të humanitetit të përgjithshëm

Niveli i mesëm

2GJLSHK.2.2.9. Në bazë të veprave të letërsisë shqipe dhe botërore nxënësi i zhvillon shkathtësitë dhe aftësitë e leximit dhe i thellon njohuritë me rëndësi për interpretimin dhe vlerësimin e veprave letrare dhe artistike dhe letrare dhe shkencore dhe për zhvillimin e identitetit gjuhësor, letrar, kulturor dhe kombëtar; ka shije të ndërtuar për lexim që duhet ta ketë një njeri i arsimuar dhe i kulturuar.

- E kupton veprën letrare si krijim estetik dhe dokument kulturor-historik
- E kupton dhe e interpreton rolin dhe vendin e leximit dhe të interpretimit të letërsisë në krijimin e identitetit të vet personal kulturor, kombëtar dhe shoqëror.
- E kupton zhvillimin dhe historinë e gjuhës shqipe dhe mënyrën e raportit të letërsisë ndaj tij.

Niveli i përparuar

2GJLSH.3.2.9. Në bazë të veprave të letërsisë shqipe dhe botërore dhe literaturës dytësore i zgjeron njohuritë e leximit, i aplikon strategjitë e leximit të cilat janë të harmonizuara me llojin e veprës letrare dhe me qëllimet për lexim (përjetimi, hulumtimi, krijimtaria): e zhvillon identitetin gjuhësor, letrar, kulturor dhe kombëtar

- E trajton në mënyrë analitike veprën letrare si krijim estetik dhe si dokument kulturor dhe historik.

- I interpreton veçoritë shoqërore dhe kulturore dhe ndryshimet më të rëndësishme historike dhe shoqërore të epokave të ndryshme dhe përgjigjen e letërsisë lidhur me to, si edhe vendin dhe rolin e letërsisë në shoqëri;

- I njeh arritjet më të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare dhe veprat artistike të kohërave të ndryshme dhe në mënyrë interpretuese i vë në lidhje kulturologjike me vepra letrare.

Niveli bazë

2.2.3 Shembujt e detyrave

Në këtë kaptinë janë dhënë detyrat me të cilat i ilustron disa standarde në fushën e Letërsisë. Është e domosdoshme që nxënësi të ketë të zhvilluar shkathtësinë e leximit dhe të kuptuarit që ta zgjidhë detyrën.

2GJLSH.1.2.1. Njeh autorët nga programi i përcaktuar shkollor dhe i vendos në kontekst të opusit krijues dhe në kontekst letrar-historik.

Detyra 1

2GJLSH.1.2.1.	Niveli bazë
Kush është autor i fragmentit në vijim?	
<p>Këtu e sipër, shtypi i Suedisë nisi të botojë lajme për disa ndryshime që po bëheshin në Shqipëri: Kongresi i Lushnjës dhe ca më vonë kryengritja e Vlorës, u duknë si shenja jete dhe fuqi morale nga ana e popullit shqiptar. Dr. Gjilpëra i vazhdonte me interes zhvillimet. Kish pasur kurdoherë një ndjenjë kurioziteti për Shqipërinë. Patriot, në kuptimin e ngushtë të fjalës, nuk ish. Mendonte si Sokrati, i cili thosh se nuk ish as athenian as grek, po “qytetar i botës”, mendonte si i urti i kohëve moderne, Gëte, i cili refuzoi të marrë pjesë në lëvizjen patriotike të Gjermanisë kundër Napoleonit, se edhe Gëteja e quante veten një “qytetar të botës” si Sokrati.</p>	
Zgjidhja	
Faik Konica	

Detyra 2

2GJLSH.1.2.2.	Niveli bazë
Lexo paragrafin nga tregimi <i>Një natë në Stamboll</i> të Nonda Bulkës. Përqëndro vëmendjen në format e tregimit në tekst.	
<p>Nata ka mbuluar me krahët e vet Stambollin. Dritat e shtëpive të qytetit po shuhën njëra pas tjetrës. Në një dhomë, buzë një rrugice të ngushtë, dritat nuk shuhën akoma. Është dhoma e punës e një shqiptari të madh.</p>	

<p>Nga dritarja e vogël, drita duket ende. Brenda në dhomë ndodhet rilindasi i madh. I rrethuar nga librat, është ulur në një kolltuk të vjetër dhe shkruan. ... Nga kalldërmi i rrugës së ngushtë vazhdon të kumbojë zhurma e hapave të zaptijeve.</p> <p>Dinjitoz, i heshtur, i vrazhdë, i brengosur nga të therurat e gjunjëve, nga reumatizmi i pashërueshëm, ai vazhdon të shkruajë. Kohë pas kohe e lëshon punën mbi tryezë dhe diku i mbërthen sytë. Ai ëndërron dhe shkruan, shkruan dhe ëndërron.</p> <p>Rretho shkronjën para atyre formave të treguarit të cilat i vëren nga paragrafi i dhënë.</p> <p>a) dialog b) narracion c) përshkrim d) monolog e) monolog i brendshëm</p>
Zgjidhja
b), c), e)

Detyra 3

2GJLSH.2.2.1.	Niveli bazë
<p>Lexo pjesën e tregimit <i>Një natë në Stamboll</i> të Nonda Bulkës.</p> <p>Nga dritarja e vogël, drita duket ende. Brenda në dhomë ndodhet rilindasi i madh. I rrethuar nga librat, është ulur në një kolltuk të vjetër dhe shkruan. ... Nga kalldërmi i rrugës së ngushtë vazhdon të kumbojë zhurma e hapave të zaptijeve.</p> <p>Si është realizuar qasja artistike në formimin e figurës Sami Frashërit në këtë paragraf.</p> <p>Rretho shkronjën para përgjigjes.</p> <p>a) vetkarakterizimin (figura flet për veten) b) karakterizimin e drejtpërdrejtë (tregimtari menjëherë flet për figurën) c) karakterizimin indirekt (figura formësohet në mënyrë indirekte – me ndodhitë, ngjarjet dhe të ngjashme) d) Argumento përgjigjen tënde duke u thirrur në tekst</p>	
Zgjidhja	
<p>b) me karakterizimin e drejtpërdrejtë</p> <p>Përgjigjja e pranueshme</p> <p>Psh., Karakterizimi i drejtpërdrejtë realizohet kur narratori menjëherë interpreton figurën në pjesën e tij.</p> <p>Tregimi pasqyron anë të rëndësishme të realitetit. Ai ka një temë rreth së cilës shtjellohet gjithë materiali gjuhësor. Trajtimi shkurt dhe gjuha tregimtare bëjnë që përmes tregimit të ndiqet dinamika e jetës. Duke qenë një krijim artistik, tregimi i jep një mesazh lexuesit i cili përmban një sasi informacioni të veshur me anën estetike dhe me ndjenjat e autorit.</p>	

Detyra 4

2GJLSH.3.2.2.	Niveli bazë
<p>Lexo vargjet e vjershës <i>Fjalët e qiririt</i> dhe trego çfarë figure ka përdor autori:</p> <p>Në mes tuaj kam qëndruar E jam duke përvëlur, Që t'u ap pakëzë dritë, Natënë t'ua bënj ditë. Do të tretem, të kullohem, E të digjem, të përvëlohem, Që t'u ndrinj mir' e të shihni, Njëri-tjatërintë njihni.</p> <p style="text-align: center;">Nga Naim Frashëri</p> <p>a) epanastrofesë b) personifikimit c) anadiplozës d) oksimoronit</p>	
Zgjidhja	
b)	

Detyra 5

2GJLSH.3.2.4.	Niveli bazë
<p>Në bazë të vargjeve të vjershës <i>Fjalët e qiririt</i>, përkufizo çfarë duhet të jetë poezia për të cilën këndohet. Argumento përkufizimin tënd dhe shkruaj vargjet, të cilët sipas mendimit tënd më së miri ilustrjnë përkufizimin tënd.</p> <hr/>	
Zgjidhja	
<p>Përgjigje të pranueshme: të gjitha përgjigjet në të cilat nxënësi thekson se më e rëndësishmja është bukuria e të shprehurit, virtuozeiteti dhe se poezia duhet të jetë e lartësuar. Si vargje kyce duhet të theksohen <i>Do të tretem, të kullohem, E të digjem, të përvëlohem.</i> (mund të theksohen edhe vargjet tjera pas tyre, por këta kanë status obligativ.)</p> <p>Përgjigjja e papranueshme: Të gjitha përgjigjet në të cilat nuk është e pranishme dashuria për flijim që përputhet me natyrën e vjershës.</p>	

Detyra 6

2GJLSH.1.2.3.	Niveli bazë
Lexo strofat në vijim nga vjersha _____. Mbaj vëmendjen në vargjet e nënvizuara pastaj përgjigju sipas kërkesës poshtë tekstit.	
Vjersha	
Në strofën e parë dhe të dytë janë të nënvizuar disa vargje. Në vijën afër secilit interpretim të vargjeve të nënvizuara, shkruaj cilit interpretim takon qasja e jashtme , si dhe cilit interpretim i takon qasja e brendshme .	
Interpretimi për strofën e parë: Vajza për subjektin lirik paraqet ndriçimin. Me qasjen ____ tregohet bukuria e saj. Qasja _____.	
Interpretimi për strofën e dytë: _____. Qasja _____.	
Zgjidhja _____	
Interpretimi për strofën e parë: qasja e brendshme	
Interpretimi për strofën e dytë: qasja e jashtme	

Detyra 7

2GJLSH.1.2.4.	Niveli bazë
Lexo me kujdes pjesën nga romani <i>Lumi i vdekur</i> i Jakov Xoxës. Rretho shkronjën para fjalisë që tregon mendimin poetik të autorit.	
a) Xoxa është i entuziazmuar nga lumenjtë si gjeografi. b) Xoxa është i entuziazmuar nga lumenjtë që përmbushin kërkesat e njerëzve. c) Xoxa është i entuziazmuar me atë që është e paparë ndonjëherë dhe që lumi paraqet e simbolizon. d) Xoxa është i entuziazmuar nga lumenjtë në Gjermani, Itali, Austri, Kroaci.	
Zgjidhja	
c)	

Detyra 8

2GJLSH.2.2.1.	Niveli bazë
Ekziston interpretimi se teksti <i>Lumi i vdekur</i> nuk flet vetëm për “lumenj”. Si është në tekst raporti mes bukurisë dhe kalueshmërisë kohore? Rretho shkronjën para interpretimit të pranueshëm.	
a) Sa më shumë që kalon koha, bukuria më shumë humb. b) Bukuria nuk varet nga koha e kaluar c) Bukuria varet nga vitet që ka ai që e shikon. d) Sa më shumë që kalon koha, bukuria zhvillohet	
Argumento përgjigjen tënde duke interpretuar tekstin	
Zgjidhja	
d) Sa më shumë që kalon koha, bukuria zhvillohet	
Përgjigja e pranueshme:	

Psh. Kur autori flet për pamjen e Vitës dhe bukurinë e saj. *Vetëm kurrizi i mirrte pak përpara, sikur t'i ishte thyer nga barra e punëve të shtëpisë. Po jo, në këtë moshë, s'ka c'i bën puna shtatit të një vajze si Vita. Shpatullat e mbledhura varfërisht e sipër të futur e të fshehur nën vete krahorin e përhedhur, do të kenë ndonjë shkak tjetër.*

Detyra 9

2GJLSH.2.2.2.	Niveli bazë
<p>Nënvizo në tekst së paku dy fjali në të cilat tregimtari nuk i shikon -----, por edhe si simbole.</p> <p>Sqaro pse mendon se është përdorur simboli.</p> <p>1. _____</p> <p>2. _____</p>	
Zgjidhja	
Pranohet secila fjali e nënvizuar e cila ----- i paraqet si diçka më shumë e më me vlerë.	

Detyra 10

2GJLSH.1.2.5.	Niveli bazë
<p>Lexo vargjet që janë marrë nga një sonet.</p> <p>M'largon buz'qeshja jote çdo furtunë, Shikimi yt më ngroh më shumë' se flaka; Këngë e hyjnueshme e moshës së re M'duket e fjalëstënde harmonia. Rrethuar rrezesh t'ndritshme virgjërore, E admiruar nga çdokush në rrugë, Ndoshta përbuz dëshirën e k'saj zemre,</p> <p>Nga Zef Serembe</p> <p>Soneti përbëhet nga:</p> <p>a) Dy katrena e dy tercina b) Një katrenë e dy tercina c) Dy katrena e tri tercina d) Një katrenë e tri tercina</p>	
Zgjidhja	
a)	

Detyra 11

2GJLSH.1.2.6	Niveli bazë
<p>Lidh autorët dhe veprat me epokat letrare – historike të dhëna që i përkasin – ashtu që do të përshkruash numrin përgjegjës në fushën pranë veprës në fjalë. Një vepër nuk i përket asnjërës nga epokat</p> <p>a) Francesco Petrarca Kanconieri _____ 1. Moderne (e pas L2B) b) Mid'hat Frashëri Hi dhe shpuzë _____ 2. Romantizëm c) Alber Kamy I huaji _____ 3. Humanizmi dhe renesansa d) Pashko Vasa Bardha e Temalit _____ 4. Realizëm e) Jakov Xoxa Lumi i vdekur</p>	
Zgjidhja	
<p>a) ----- 3 b) ----- 4 c) ----- d) ----- 2 e) -----1</p>	

Detyra 12

2GJLSH.1.2.7.	Niveli bazë
<p>Njëri nga problemet themelore në romanin <i>Procesi</i> të Franc Kafkës është fajësia e Jozef K. A është sipas tekstit të romanit Jozef K. fajtor?</p> <p>PO JO</p> <p>Argumento përgjigjen duke u mbështetur në tekst të romanit</p> <hr/>	
Zgjidhja	
<p>Pranohet edhe përgjigjja PO edhe përgjigjja JO – nëse argumentimi mbështetet në tekstin e romanit (sjellja e figurës, pamja e tij, mendimi, raporti i figurave të tjera ndaj Jozef K. Dhe të ngjashme). Psh.:</p> <p>PO - Jozef K. Nuk revoltohet kur e arrestojnë. Krijohet përshtypja se ai pranon fajësinë dhe aktakuzën për diçka që nuk e ka bërë. Nuk ngre zërin kundër aktgjykimit, e pret me qetësi. Sillet sikur fajtor, i fiksuar nga fajësia.</p> <p>JO – Jozef K. deklaron se nuk është fajtor. Nuk e di se për çka po gjykohet. Është plotësisht i pafuqishëm dhe dëshiron të lirohet nga gjykata, sepse ndjehet i pafajshëm. Interesohet te daja, te avokati dhe fotografisti se si të lirohet nga gjykata. Mendon se është i fajësuar.</p>	

Detyra 13

2GJLSH.1.2.8.	Niveli i mesëm
<p>Në bazë të literaturës, cakto cilës poezi popullore i takon kjo këngë:</p> <p>Nina – nana more bir Flej, se gjumi të ban mirë</p> <p>T’u baftë shtati si bajrak E t’u mbushtë fytyra me gjak; M’u bafsh, bir, ti plak i vjetër Plak i vjetër, zotni i pshtetun... O more, bir, t’u dhashtë e mbara Porsi lulja që çile ndër ara. ...</p> <p>a) lirikë familjare b) lirikë shoqërore c) lirikë e dashurisë</p>	
Zgjidhja	
a)	

Detyra 14

2GJLSH.3.2.8.	Niveli i mesëm
<p>Lexo këngën popullore dhe trego veçoritë nëse</p> <p>Kah kam vlla e kah kam motër, Deksh pra, n’u martofsh! Se gjithë gratë e Jutbinës ku janë, Bash si motra qi po m’duken, Dheu m’ka mbulue e fat s’i qita vendit, Po s’e mora Tanushen e Krajlit, E unë Tanushën vetë e kom’pa Kur kam pas besë me Krajli; Gja ma t’mirë s’shef njeri nën këtë diell! Vetlla e saj drejt si fiskaja; Shteku i ballit, si shteku i malit Kur merr hana me prarue; Syni i saj si kokrra e qershisë; Ka qerpikun si krahi i dallëndyshes; </p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kënga është rezultat i besimeve magjike që mbështetet në mendimin mitik. 2. Kënga është rezultat i mendimit religjioz që mbështetet në traditën fetare (shqip). 3. Kënga është kënduar me kalimin e kohës në çastet e pushimit. 4. Kënga ka qenë pjesë përbërëse e strukturës së ceremonisë rituale. 5. Kënga ka ngritur ndjenjat në rrethin e ngushtë, mes ekzekutuesve të saj. 6. Kënga ka ngritur ndjenjat në bashkësinë e gjerë kulturore. 7. Kënga shpreh varësinë e njeriut nga fuqitë natyrore që kanë formë të botës së gjallë 8. Kënga shpreh varësinë e njeriut nga shfaqjet e kuptueshme natyrore nëpër cikle. 9. Kënga me zgjedhjen e motivit dhe tempos imiton shfaqjen natyrore. 10. Kënga ka domethënie simbolike. 	

Zgjidhja
1), 3), 5), 6), 10)

Detyra 15

2GJLSH.2.2.1.	Niveli i mesëm
Lexo me kujdes vjershën <i>Bagëti e bujqësia</i> të Naim Frashërit.	
Interpreto vjershën ashtu që të theksosh:	
<ul style="list-style-type: none"> - përjetimin tënd nga vjersha - shtresën tematike-motivuese - së paku dy aspekte gjuhësore-stilistike që i kontribuojnë melodisë së poezisë/muzikalitetit të vargut. 	
Përgjigja: _____	
Zgjidhja	
<p><u>Përjetimi i vjershës</u> - Pranohet secila përgjigje në të cilën përjetimi i lexuesit formohet në shikimin e thellësisë simbolike/ajo që lë të kuptohet nga poeti dhe rrëfimi lirik i vjershës.</p> <p><u>Shtresa tematike – motivuese – tema</u> është atdheu dhe rrethi motivues tematik është dashuria për atdheun (psh.: bukuria e jetës baritore në atdhe, dashuria dhe malli për vendlindjen, bukuria e natyrës së atdheut që krahasohet me perëndinë, idealizimi i vendlindjes etj)</p> <p>Aspekti gjuhësor – stilistik – përgjigja e pranueshme duhet të përmbajë interpretimin nën</p> <p>1. Figurë qendrore është apostrofi, pastaj krahasimi, epiteti, metafora e simboli; 2. Vargu tetërrokësh i dyfishuar; 3. Rima AABB; 4. Kompozicioni i kontribuon muzikalitetit të vargjeve. (Vërejtje: Mjafton që nxënësi të thotë dy aspekte.)</p>	

Detyra 16

2GJLSH.2.2.6.	Niveli i mesëm
Lexo fragmentin dhe përgjigju:	
<p>“Rroftë jeta!” Ashtu më dukej sikur përsërisnin ditë e natë, e sidomos natën, kur oshëtima e tyre ishte më e fuqishme, dallgët detit Jon, që përplaseshin në bregun shkëmbor, të fshatit tim Dhrimadhe. Këtë refren të përhershëm të dallgëve të detit Jon më dukej sikur shprehnin pa zë dhe fshatarët e mi, se lufta që bënin, atë moto kishte: “Rroftë jeta!”, jeta mbi gurë, jeta në dallgët e detit, jeta kur ishte zor të jetoje, zor të dashuroje, zor të ëndërroje dhe zor të vdisje. Ky refren i pashpallur me zë, me vaj apo me këngë, që pulsi i nxitjes për të jetuar me luftë të ashpër mbi gurë me furtunat që rrëmbenin dhe dheun e gërxheve.</p> <p>Kaloje nga një monopati dhe shikoje ndonjë burrë që ngrinte ledhe për t’i mbushur pastaj me dhe dhe e pyesje: - Ç’po bën aty? – Dhe ai të përgjigjej: - Ja, luftoj!</p> <p>Shihje ndonjë grua që bënte dru në pllaja të pjerrëta, gërxhore dhe të zhveshura, se dhitë nuk i linin kurrë xinat, çfakat dhe anitçfakat të rriteshin, dhe e pyesje: - Ç’po bën aty? – Dhe ajo të përgjigjej: - Ja, luftoj!</p> <p>Shikoje në prakun e dyerve të oborreve plaka të heshtura që turrnin duke shikuar detin, detin që u kishte marrë burrin apo djalin, dhe i pyesje: - Ç’po bëni aty? – Dhe ato të përgjigjeshin: - Ja luftojmë!</p>	
Nga Petro Marko	

<p>Elementet letrare të këtij fragmenti janë tipike për letërsinë:</p> <p>a) letërsi e vjetër b) romantizëm c) klasicizëm d) realizëm e) modernizëm</p>
Zgjidhja
e)

Detyra 17

2GJLSH.2.2.2	Niveli i mesëm
<p>Lexo këtë fragment nga Elizabet Enrajt dhe përgjigju kërkesës:</p> <p>Ç'vapë që është! – i tha ajo Garnetës. – Ku po shkon kështu? Të marr letrat, - u përgjigj Garneta. Pastaj mund të shkojmë të lahemi në lumë, - shtoi ajo. Kurse unë duhet t'i ndihmoj mamasë për të hekurosur, tha Sitronela me keqardhje. – Lëre se ç'punë e mirë është të hekurosësh në një ditë të tillë. Garneta qeshi dhe vazhdoi të zbriste teposhtë rrugës. Prit një minutë, - i thirri Sitronela – se mbase do të ketë letra edhe për ne. Dhe të dyja vajzat vrapuan së bashku nëpër tatëpjetën e rrugës. Sa do të dëshiroja, - i tha Sitronela, - sikur, në një ditë të tillë, të gjeja një lumë, ku, në vend të ujit, të kishte limonadë të ftohtë. Gjithë ditën do të zhytesha e do të qëndroja në të me gojën e hapur. Kurse unë do të dëshirojë të isha lart, në Alpet, - tha Garneta. – Ti i di ato male të Evropës. Mbi majat e tyre ka borë edhe në ditët më të nxehta më të verës. Sa qejf kam të ulem një herë përmbi borë!</p> <p>Kujt i përket zëri i narracionit dhe kujt pika e vështrimit në testin e dhënë? Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.</p> <p>a) Zëri dhe pika e vështrimit i takojnë tregimtarit të gjithdijshëm b) Zëri i përket narratorit, kurse pika e vështrimit vajzave. c) Zëri i përket narratorit, kurse pika e vështrimit është dyfishe (narratori dhe vajzat) d) Zëri i përket tregimtarit autoritar, kurse pika e vështrimit tregimtarit të pasigurtë.</p>	
Zgjidhja	
a) Zëri i përket narratorit, kurse pika e vështrimit është dyfishe (narratori dhe vajzat)	

Detyra 18

2GJLSH.2.2.5	Niveli i mesëm
<p>Lexo vjershën dhe përgjigju cilit lloj të poezisë lirike i takon:</p> <p>Nënë moj, mbaj zi për vëllanë Me tre plumba na e vranë Na e vran' e na e shanë Na i thanë tradhëtor. Se të deshte kur s' të deshnin Se të qante kur të qeshnin Se të veshte kur të zhveshnin Nënë moj të ra dëshmor</p> <p>a) Himni b) Oda c) Ditirambi d) Epigrami e) Epitafi f) Idila g) Elegjia</p>	
Zgjidhja	
g)	

Detyra 19

2GJLSH.2.2.6.	Niveli i mesëm
<p>Duke marrë parasysh format poetike të epokës së cilës i përket Hajnrih Hajne, në bazë të vargjeve të këngës Lorelaj shpjego gjykimet në vijim: “Bukuria është forma e lartë e ekzistencës. Ajo vjen nga lart sikur dicka që është mbi njeriun dhe botën”.</p> <p>Lorelaj Se c'kam kështu, s'e di as vetë, Jam i trishtuar shumë; Nga një rrëfenjë mjaft e vjetër, Që s'e kam sajuar unë.</p> <p>Është freskët, muzgu po vjen, Rrjedh qetësisht lumi Rin (Rajna) Majat e maleve shkëlqen Drit e mbrëmjes në perëndim.</p> <p>Vjen një vashë e re dhe qëndron Ja, ulet diku në breg, Xhevahiret e saj zbulon Flokët e saj të artë kreh.</p> <p>I kreh me një krehër të artë</p>	

Dhe ia merr këngës si di;
Me zërin mrekullisht të qartë
Një të ëmbël melodi.

Detarit në të voglën anije
Ja ndolli të keqen sakaq;
Mbi ujë majat e shkëmbinjëve
S'i pa, hutuar shihte lart.

Thonë dallgët i gllabëruan
Anijen dhe detarin e saj;
Këtë bëri duke kënduar
Atë këngë Lorelaj.

Rendit argumentimin duke pasur parasysh vargjet e këngës.

Zgjidhja

Përgjigja e pranueshme

Nxënësi shfrytëzon format poetike të romantizmit në interpretimin e këngës.

- (1) E pranueshme është secila përgjigje e cila në vete përmban argumentimin se vajza është simbol i bukurisë dhe se fotografia në cilën gjendet ajo në maje të kodrës në të cilën gjendet edhe dielli (i mbrëmjes në perëndim), konfirmon gjykimin e dhënë se bukuria është sipër dhe vjen nga lart.
- (2) E pranueshme është edhe përgjigja që aludon se në këngë është përshkruar vila, dhe kjo tregon se bukuria është diçka më shumë se njeriu i thjeshtë dhe bota, sepse njeriu (detari) i cili është i hipnotizuar me të, shkon në vdekje – që konfirmon se bukuria është sipër njeriut.

Vargjet që këtë konfirmojnë

Majat e maleve shkëlqen
Drit e mbrëmjes në perëndim.

Vjen një vashë e re dhe qëndron

Ja, ulet diku në breg,

(ose)

Mbi ujë majat e shkëmbinjëve

S'i pa, hutuar shihte lart.

Thonë dallgët i gllabëruan

Anijen dhe detarin e saj;

Përgjigje e papranueshme

Çdo përgjigje e ofruar që nuk merr parasysh së paku njërin nga dy shpjegimet e dhëna.

Vërejtje: Nxënësi mundet (jo patjetër) të theksojë vargjet të cilat konfirmojnë gjykimet e dhëna në detyra, ose t'i referohet pjesës së vargjeve; ose në çfarëdo mënyre t'i theksojë (tekstualisht, t'i parafranojë etj.)

Detyra 20

2GJLSH.2.2.7.	
<p>Çka mund të simbolizojë ushtria te <i>Gjenerali i ushtrisë së vdekur</i> të Ismail Kadarese?</p> <p>Rretho përgjigjen para përgjigjes së pranueshme dhe pastaj argumento përgjigjen tënde duke iu referuar tekstit parësor.</p>	
<p>Ushtria simbolizon</p> <p>a) Forcë b) Autoritet c) Dinjitet</p>	
<p>Argumentimi: _____</p>	
<p>Nëse nuk pajtohesh me ndonjërin prej përgjigjeve të ofruara, vendos ti çka simbolizon ushtria dhe argumento përgjigjen tënde.</p> <p>_____</p>	
Zgjidhja	
<p>Përgjigjet e pranueshme bazohen në interpretimin e romanit.</p> <p>Psh.</p> <p>a) Forcë – Ushtria përnjëmend nënkupton forca të armatosura që mbajnë mbi supe mbrojtjen dhe sigurinë e një vendi. Këtu kemi një ushtri të kthyer në thasë të najlontë. Koha e luftës dhe e pasluftës janë fragmente të së njëjtës hapësirë që plotësojnë dhe zbulojnë njëra – tjetrën. Lufta e ka hedhur kohën në erë, koha e ka kryqëzuar luftën në shtyllën e turpit.</p> <p>b) Autoritet – Kjo nuk vihet në diskutim në zhvillimin e një ushtrie. Misioni i gjeneralit italian ndërkaq, në shikim të parë është i shenjtë por lufta e tij me baltën flet për autoritetin e tij jo të njëjtë sikur të kishte të bënte me ushtri reale. Shkëlqimi i rremë i misionit të gjeneralit e ka burimin në ndëshkimin që vetë historia i kishte dhënë ushtrisë pushtuese, duke e damkosur me mundjen si kapitullim.</p> <p>c) Dinjitet – Edhe dinjiteti është pjesë përbërëse e veprimeve ushtarake. Luftërat do të duhej të ishin dhe të jenë të dinjitetshme. Nënata italiane presin eshtrat e bijëve të tyre, të cilët, pavarësisht se luftën e bënë në një vend të huaj, ata meritojnë varrim të dinjitetshëm i cili në rrethana lufte, ndoshta ka qenë i pamundur.</p> <p>E pranueshme është secila përgjigje e cila e përkufizon natyrën e <i>Gjeneralit të ushtrisë së vdekur</i> bashkë me argumentimin e mbështetur në tekstin parësor, pra romanin.</p>	

Detyra 21

2GJLSH.2.2.3.	Niveli i mesëm
<p>2GJLSH.2.2.3. Dallon metodat e qasjes së brendshme e të jashtme në interpretimin e pjesëve apo veprave letraro-artistike dhe llojet letraro-shkencore dhe publicistike.</p>	
<p>Zbato metodën biografike në interpretimin e figurës së nënës nga fragmenti _____</p> <p>_____</p>	

Zgjidhja
<p>E pranueshme do të jetë secila përgjigje e cila lidh fatin tragjik të nënës, raporti i saj me familjen patriarkale me figurën e nënës nga historia e shkurtër.</p> <p>Psh.: Nëna është e dashur dhe e pafat, sepse ndjenjat e mëdha të vesit dhe kotësisë dëmtojnë themelet e jetës. Është evident ndikimi i nënës te fëmijët, edukimi emocionet, që është fakt biografik, por edhe motiv letrar. Nëna përkujdeset që (...)</p> <p>E papranueshme është ajo përgjigje e cila nuk lidh faktografinë biografike me transpozimin letrar.</p>

Detyra 22

<p>2GJLSH.3.2.4. 2GJLSH.3.2.2. 2GJLSH.2.3.2. 2GJLSH.2.3.3.</p>	<p>Niveli i përparuar Niveli i mesëm</p>
<p>Gjendesh në rolin e kritikut letrar. Shkruan rubrikën për poezinë bashkëkohore për revistën e shkollës tuaj.</p> <p>Detyra jote është që së pari të lexosh vjershën MALL të Ismail Kadaresë, dhe pastaj të vendosësh t’u propozosh të njëjtën për lexim shoqeve dhe shokëve.</p> <p>Shkruaj përmbajtjen për vjershën ashtu që teksti yt të qëndrojë brenda përkufizimit të dhënë. Në përmbledhje argumento qëndrimin tënd për vjershën që të cilët i referohen interpretimit të vjershës. Mundesh p.sh.: të shkruash për motivin e këngës, idenë, vargun, qasjen stilistike dhe për elementet tjera strukturore poetike të vjershës.</p> <p style="text-align: center;">MALL</p> <p>Ca pika shiu ranë mbi qelq, Për ty unë befas ndjeva mall, Jetojmë të dy në një qytet, Dhe rrallë shihemi sa rrallë.</p> <p>Edhe m’u duk pak e çuditshme Si erdh kjo vjeshtë, ky mëngjes, Qiejt e ngrisur pa lajlekë, Dhe shirat pa ylberë në mes.</p> <p>Dhe thënia e vjetër e Heraklitit Seç m’u kujtua soit për dreq: <<Të zgjuaritjanë bashkë në botë, Kurse të fjeturit janë veç>>.</p> <p>Në ç’ëndërr kemi rënë kaq keq, Që dot s’po zgjohemi ne vallë?... Ca pika shiu ranë mbi qelq Dhe unë për ty seç ndjeva mall.</p> <p style="text-align: center;">Nga Ismail Kadare</p> <p>Puna jote do të vlerësohet në bazë të:</p> <p>Qëndrimi yt sa i përgjigjet temës të cilën të kemi dhënë; A merr qartë qëndrim për vjershën;</p>	

A i mbështet argumentet tuaja në interpretim të vjershës;
 A përdor terminologjinë përgjegjëse teorike -letrare ;
 Sa përkujdesesh për kompozicionin e përmbajtjes;
 Sa përkujdesesh për përshtatjen gramatikore të fjalisë në kuptimin e saj;
 Sa i zbaton rregullat drejtshkrimore.

Zgjidhja

Në këtë detyrë me metodë analitike në mënyrë të pavarur vlerësohet arritshmëria e tri standardeve
Për 2GJLSH.3.2.4.

Nxënësi thekson se a i preferon apo jo vjershën për lexim shokëve të tij. Interpreton vjershën duke u thirrur në format e saj poetike.

Për 2GJLSH.3.2.2.

Arsimtari vlerëson se a përdor nxënësi terminologjinë relevante teorike-letrare në interpretimin e vjershës.

Për 2GJLSH.2.3.2.

Arsimtari vlerëson se teksti i përmbajtjes i përgjigjet tekstit kompleks:

A po e jep idenë e tij nxënësi dhe a po e argumenton qëndrimin e tij;

A po përkujdeset nxënësi që të shkruaj diçka interesante;

A po e ndërton nxënësi digresionin e përshtatshëm dhe zgjedh detaje interesante dhe shembuj përgjegjës;

A po e paraqet nxënësi përjetimin e tij dhe përshtypjet me rastin e pjesës letrare;

A po e vëren nxënësi thelbin e pjesës letrare;

A po e zbaton normën drejtshkrimore në rastet e parapara me program.

Për 2GJLSH.2.3.3.

Arsimtari vlerëson nëse nxënësi ka të formuar shijen e leximit dhe a po i zbaton strategjitë komplekse të leximit; a po e zgjedh strategjinë e leximit e cila i përgjigjet qëllimit të leximit (psh.: a po e lidh pjesën me shembuj nga jeta, a po e rezymon tekstin, a përgjigjet në pyetjet e parashtruara në lidhje me interpretimin e tekstit dhe të ngjashme)

Detyra 23

2GJLSH.3.2.7

**Niveli i
avansuar**

Fragmenti në vijim nga romani *Lumi i vdekur* i Jakov Xoxës hap problematikën të cilën romani e zhvillon.

Lexo me kujdes tekstin.

Gjithë djelmuria e Grizës shkallonte pas asaj çupe. Duke fshehur bukuritë që natyra ia kishte falur me të dy duart ajo shtonte akoma më shumë, pa e ditur, nepsin e çapkënëve dhe remashëve të fshatit. Por gjer ahëre asaj s'ia kishte ngritur dot sytë dhe shtatin: siç duket, qerpikët e Vitës kishin qëlluar shumë të rëndë.

Çuditej e linte mendjen vajza me ato çupat e qytetit: Si bajamet e pranverës edhe ato ... që s'presin sa të çelin lulet e para, për të ndjellë në gjirin e tyre bletët që do t'i trazojnë dhe gudulisin!...

Kurse ajo?... Ajo turpërohej edhe nga njerëzit e shtëpisë, edhe nga vetja e saj.

(...)

Gjer më sot asaj s'i kishte rrahur zemra për asnjë nga djemtë e fshatit

Mes përgjigjeve të ofruara zgjidh një problem të theksuar që ngritet nga romani në fjalë.

- a) Problemi individual (psikologjik)

- b) Problemi shoqëror (vendi individit në shoqëri)
- c) Problemi historik (çështja e besueshmërisë historike dhe të ngjashme)

Argumento problemin e vërejtur në tekstin e dhënë (fragment nga romani *Lumi i vdekur*) dhe në kontekstin letrar – filologjik (psh. romani *Lumi i vdekur* në tërësi, pjesë të të njëjtit shkrimtar, pjesë tjera nga letërsia artistike ose popullore të cilat ngritin problemin e njëjtë, nga të njëjtat ose epokat e ndryshme).

Përgjigja: _____

Zgjidhja

Teksti primar i romanit *Lumi i vdekur* (problemi individual – psh. dëshprimi në veten dhe të tjerët, psikologjia e individit në rrethana të reja; problemi shoqëror – psh.: ndjenja që i përket shoqërisë dhe kërkesa për shoqëri të re, premtimi për jetë më të mirë etj; problemi historik - lëvizjet shqiptare për liri, shpërnguljet e njerëzve nga Kosova në Shqipëri, fillimi i jetës së re me njerëz të rinj, por të të njëjtit komb etj., dhe të ngjashme) dhe Konteksti letrar – filologjik --- përveç argumentimit nga teksti parësor, nxënësi krahason romanin *Lumi i vdekur* me tjetrin – në sinkronizim (avangarda letrare) ose në diakroni, në kuadër të letërsisë shqipe ose botërore.

Vërejtje: konteksti letrar-filologjik është i paraparë me programin mësimor.

2.3 KULTURË GJUHE

Kultura gjuhësore përfshin të folurit, të dëgjuarit, leximin dhe shkrimin (me të cilin rast këto fusha gërshetohen dhe përputhen). Nxënësi aftësohet që në mënyrë gjuhësore të marrë pjesë në shoqëri si anëtar i saj me të drejta të plota: të hartojë dhe të kuptojë tekste të folura dhe të shkruara të llojeve të ndryshme, të ekspozojë në situatën zyrtare për temat nga gjuha, letërsia dhe kultura, që në mënyrë përkatëse të marrë pjesë në diskutime: të fitojë aftësi dhe shprehje që të lexojë për qëllime të ndryshme (informimi, mësimi, zhvillimi personal, përjetimi estetik, argëtimi...), dhe kështu ta kultivojë kulturën e të folurit të vet.

Niveli i arritjeve sipas ndërlikueshmërisë së tekstit të cilin e dëgjon nxënësi, e lexon ose e harton vetë (me gojë ose me shkrim). Në nivelin bazë të arritjeve nxënësi flet për tema më të thjeshta për gjuhën, letërsinë dhe kulturën dhe dëgjon me vëmendje ekspozimin e tekstit mesatarisht të vështirë. Në nivelin e mesëm dhe të përparuar të arritjeve nxënësi lexon tekste më të ndërlikuara dhe më të vështira.

Nivelet e arritjeve dallohen edhe sipas ndërlikueshmërisë së proceseve mendore: në nivel bazë të arritjeve nxënësi e kupton tekstin me një ndërlikueshmëri dhe vështirësi të caktuar, kurse në nivelin e mesëm dhe të përparuar shqyrton edhe në mënyrë kritike (i vëren qëndrimet e autorit – eksplicite dhe implicite, dhe vlerëson me logjikë, origjinalitetin dhe vlerën e stilit të tekstit); në nivel të përparuar pritjet që në mënyrë të thelluar ta studiojë në mënyrë kritike, dhe ta bëjë klasifikimin e informacioneve dhe të ngjashme.

NIVELI BAZË

2GJLSH.1.3.1. Flet qartë gjuhën standarde. Lexon, kupton dhe analizon tekstet letrare e joletrare. Përdor gjuhën letrare duke u mbështetur në rregullat gramatikore të gjuhës shqipe. Përdor fjalë nga komunikimi i përditshëm. I njeh dhe i lexon autorët e veprave letrare, të cilët janë paraparë me plan dhe program të mësimi. Në analizën e veprës letrare, arrin ta dallojë mënyrën stilistike të organizimit të veprave në përgjithësi, me elemente (figura) letrare (stilistike) dhënë edhe shembuj. Di t'i interpretojë pjesët tematike (duke shprehur përshtypjet e veta) madje edhe duke dhënë shembuj për to. Nxënësi e përdor gjuhën shqipe që të mund të kuptojë, të shprehë dhe t'i përcjellë informacionet, mendimet, ndjenjat dhe qëndrimet e veta në situatë të ndryshme jetësore. Nxënësi fiton shprehje leximi dhe e ndjen nevojën që të lexojë tekste të ndryshme. Di të shkruajë dhe të hartojë tekste me përmbajtje, structure dhe destinim të ndryshim në të gjitha stilet e përdorimit.

1 – Aplikon theksimin letrar dhe gjuhësor nëse vjen nga ndonjë zonë në të cilën nuk përputhet theksi me gjuhën letrare gjuhësore, përkatësisht e krahason theksin e vet me atë letrar dhe përpiqet që theksin e vet ta harmonizojë me theksin letrar nëse dialekti i tij dallohet sipas theksit nga lgjuha letrare.

2GJLSH.1.3.2. Duke folur apo duke shkruar për ndonjë temë nga gjuha, letërsia apo për jetën shoqërore, e strukturon rrëfimin dhe i lidh pjesët në mënyrën e duhur; Dallon të rëndësishmen nga e parëndësishmja dhe i përmbahet temës kryesore; Shkruan një tekst duke u shërbyer nga përshkrimi e ekspozicioni dhe shkurtazi i përshkruan ndjenjat e tij dhe përjetimin e pjesës letrare ose të ndonjë pjese tjetër artistike; Rrëfen tekstin letrar artistik dhe i ndan pjesët kryesore. Në fund jep një përmbledhje (rezyme) të tekstit letrar ose joletrar.

1. Ekspozimi është njoftim për diçka ose shpjegim i një gjëje – pra, procedura me të cilën folësi përkatësisht autori i tekstit ekspozon diçka që ta kuptojë dëgjuesi përkatësisht lexuesi. Metodatat e ekspozimit janë krahasimi dhe kontrasti, ilustrimi, klasifikimi, përkufizimi dhe analiza.

2GJLSH.1.3.3. Në diskutime me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura, në pika të shkurtëra mund ta shprehë dhe ta argumentojë idenë ose qëndrimin për të cilin angazhohet; Pra, ai mund të flasë ngadalë duke u mbështetur kryesisht në fakte; Është në gjendje ta dëgjojë mendimin e tjetrit dhe ta marrë parasysh gjatë argumentimit të tij; Shkruan tekst me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura;

- 1- Teksti argumntues (shqyrtimi) është teksti në të cilin autori fillon nga ndonjë dyshim ose mëdyshje, e pastaj duke i theksuar argumentet vjen deri te zgjidhja. Autori i një teksti të tillë synon që me dëshmi ta bindë bashkëbiseduesin përkatësisht lexuesin në rregullsinë e mendimit të vet.

2GJLSH.1.3.4. Shfrytëzon librin drejtshkrimor të gjuhës shqipe; i zbaton rregullat elementare të drejtshkrimit dhe mund të shërbehet me botime të tjera nga Ortografia; Në të shkruar ndan pjesët tekstit, jep titujt dhe nëntitujt, citon dhe parafrazon; Bën punimin e maturës duke i respektuar rregullat e shkruarjes së punimit shkencor (përdor fusnotat, shkruan përmbajtjen dhe bibliografinë); Shkruan letra zyrtare dhe jozyrtare, biografi (CV), lutje, ankesë, kërkesë; Di të plotësojë formularë të ndryshëm etj.;

2GJLSH.1.3.5. Ka aftësinë që në mënyra të ndryshme (informim, mësim, zhvillim personal, përjetim estetik, argëtim ...) të lexojë tekstet të rëndësishme (tekstet letrare, tekste profesionale, shkencore, popullore) nga fusha e shkencës për gjuhën dhe letërsinë, tekstet nga mediet; tekstet që janë të përshtatshme për përpunimin e planit për gjuhë dhe letërsi); zbaton strategjitë e të lexuarit;

1- Bëhet fjalë për tekste që janë të përshtatshme për përpunimin e materialit nga gjuha dhe letërsia.

2GJLSH.1.3.6. Kupton tekstin letrar e joletrar dhe njeh rëndësinë e tyre, gjen informacione nga më të ndryshmet, ndan pjesët kryesore të tekstit; e di kuptimin e përmbajtjes në tekst; krahason informacionet dhe idetë nga dy e më shumë tekste.

1- Teksti joartistik mund të jetë që të përshkruajë ndonjë gjë, që të rrefejë për ndonjë gjë, që të njoftojë ose të sqarojë për ndonjë gjë, që me forcën e argumentit të bindë për diçka, ose të veprojë në mënyrë manipuluese (propaganduese).

2GJLSH.1.3.7. Në mënyrë kritike jep sqarim për tekstin letrar e joletrar; dallon faktin objektiv nga interpretimi autorial; vlerëson (dhe argumenton) se a i prezanton autori i tekstit joartistik të gjitha informacionet e nevojshme dhe a jep fakte të mjaftueshme e të besueshme për atë që thotë; vlerëson se a është neutral autori i tekstit ose i angazhuar apo i anshëm dhe e arsyeton vlerësimin e tij; njeh gjuhën e urrejtjes, diskriminimit, sharjes dhe për këto çështje ka qëndrim negativ.

2GJLSH.1.3.8. Njeh strukturën, elementet e ndryshme, figurat stilistike (metoniminë, metaforën, asonancën, aliteracionin, onomatopenë, anaforën...); Njeh domethënien e kuptimit të fjalës në kontekstin e dhënë dhe kupton qëllimin e domethënies së kuptimit në tekstin letrar dhe joartistik; vlerëson domethënien e fjalëve të panjohura në bazë të kontekstit dhe modelit të formacionit; kupton domethënien e leximit për pasurimin e fondit leksikor.

NIVELI I MESËM

2GJLSH.2.3.1. Nëpër situatat zyrtare dhe para auditoriumit më të gjerë, flet për temat nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe kulturës, duke e përdorur gjuhën letrare dhe terminologjinë përgjegjëse; merr pjesë në bisedat publike ku ka më shumë pjesëmarrës; vlerëson auditoriumin dhe e përshtat fjalimin e tij sipas mundësive dhe kërkesave të tij; në të folur duhet ta zhvillojë më shumë kulturën e tij shprehëse; me vëmendje dëgjon prezantimet nga të tjerët (psh. ligjëratat) me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura etj.

2GJLSH.2.3.2. Ndërton tekstin e folur a të shkruar nga gjuha, letërsia etj., duke e karakterizuar nga kohezioni dhe koherenca, pra me mënyrën se si lidhen midis tyre në bazë të rregullave gramatikore të gjuhës njësitë që e përbëjnë tekstin (kohezioni) dhe me organizimin logjik të tekstit me mënyrën se si gjykimet dhe arsyetimet lidhen midis tyre (koherenca); në diskutimet e shkruara apo të folura, shpreh idetë dhe argumenton qëndrimet e tij; përkujdeset që të shkruajë e të flasë drejt duke e respektuar normën gjuhësore pa bërë ndonjë shmangie nga rregullat; shfaq përjetimin dhe

përshtypjet e tij rreth pjesës letrare ose artistike; rrëfen tekstin letrar dhe jep një përfundim për të sipas mundësive të tij shprehëse; zbaton rregullat drejtshkrimore etj.

2GJLSH.2.3.3. Për të pasur një informim edhe më të gjerë, pra për ta zhvilluar aftësimin personal dhe për ta arritur përjetimin letrar e estetik, lexon tekste edhe më të ndërlikuara si tekste letraro-artistike, tekste shkencore, tekste nga mediet etj; është i dhënë pas leximit; zbaton dhe zgjedh strategjitë e përshtatshme të leximit.

- 1- Bëhet fjalë për ato tekste nga mediat që janë të përshtatshme për përpunimin e lëndësi nga gjuha dhe letërsia.

2GJLSH.2.3.4. E kupton tekstin joletrar; nxjerr thelbin e tij; gjen pjesët e nënkuptueshme, por edhe e shtjellon tekstin në fjalë; gjen idenë kryesore; krahason informacionet dhe idetë nga dy e më shumë tekste për të kuptuar aspektin domethënës e stilistik; i gjen dhe i analizon motivet dhe figurat, të cilat paraqiten në veprën letrare; interpreton tekstet duke u mbështetur në tekstet e tjera letrare.

2GJLSH.2.3.5. Në mënyrë kritike jep vlerësim për tekstin letrar joartistik; ndan faktin objektiv nga interpretimi autorial; vlerëson neutralitetin (anshmërinë) e autorit; vlerëson se a është i përshtatshëm për planin dhe programin mësimor nga gjuha dhe letërsia shqipe autori i tekstit argumentues; prezanton të gjitha informatat dhe faktet e autorit për ato që i thotë.

2GJLSH.2.3.6. Vlerëson se a është i përshtatshëm për planin dhe programin mësimor nga gjuha dhe letërsia shqipe autori i tekstit joartistik; teksti a është koheziv dhe koherent, a janë dhënë idetë qartë dhe saktë; vëren dukuritë stilistike; vëren se sa ndikojnë pjesët e caktuara të tekstit për ta kuptuar atë.

NIVELI I PËRPARUAR

2GJLSH.3.3.1. Diskuton për temat e ndërlikuara nga gjuha, letërsia dhe kultura; flet për tekstet letrare dhe joletrare duke shfrytëzuar terminologjinë profesionale.

2GJLSH.3.2.2. Prezanton në situatat zyrtare dhe para auditoriumit më të gjerë paraqitet me tema nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe kulturës; është orator dhe paraqet qëndrimet e tij para auditoriumit me argumente; gjatë ligjërimit përdor fjalë dhe shprehje nga gjuha amtare duke respektuar normën e gjuhës standarde etj.

2GJLSH.3.3.3. Shkruan në mënyrë kompozicionale e logjike tekstin profesional me temë nga gjuha dhe letërsia si edhe artikullin gazetaresk.

2GJLSH.3.3.4. I mbledh, i shënon dhe në fund i përpunon informacionet nga tekstet letrare joartistike në bazë të rregullave të parapara.

2GJLSH.3.3.5. Teksti mendon se ka një strukturë dhe organizim të brendshëm, kuptohet pa vështirësi, lexohet me kënaqësi, pra bart informacionin te lexuesi dhe është i shkruar sipas rregullave të ndërtimit të fjalive dhe të periudhave;

2GJLSH.3.3.6. I njeh stilet funksionale të shqipes standarde (stili i letërsisë artistike, stili politiko-shoqëror, stili shkencor-teknik, stili juridik-administrativ) dhe të gjitha këto (stile) mund t'i trajtojë sipas veçorive të tyre leksikore.

2GJLSH.3.3.7. Në të shkruar, përdor shenjat e pikësimit varësisht nga lloji i fjalive (dëftore, pyetëse, dëshirore, nxitëse, urdhërore).

Detyra 1

2GJLSH.2.3.4	Niveli i mesëm
<p>Lexo me kujdes tekstin <i>Gjuha amtare</i> nga Ranko Bugarski dhe përgjigju sipas kërkesave poshtë tekstit.</p> <p>Stereotipi evropian negativ i përmendur më parë për shumëgjuhësinë në planin shtetëror shtrihet edhe në individë. Në të vërtetë, shpesh besohet se – pa llogaritur mësimin e mëvonshëm të gjuhëve të huaja – disi natyrshëm që secili njeri të pranojë vetëm një gjuhë dhe të rritet me të si amtare. Kurse e kundërta me këtë qëndrim është gjykimi i mjegulluar se në dygjuhësinë individuale, në kuptimin e pranimit paralel ose të përdorimit të rregullt alternativ të dy gjuhëve, ka diçka devijuese, ndoshta edhe të papërshtatshëm për zhvillimin mental dhe socializimin e individit të tillë. Në fakt këtu është fjala pak a shumë për veprimin e fshehur të paragjyqimit ndaj popullatave të varura të pakicave, përfaqësuesit e të cilit rëndom edhe janë dygjuhësorë. Ndërkaq bartësit kryesorë të këtyre paragjyqimeve – a duhet thënë – përfaqësuesit e privilegjuar njëgjuhësor të gjuhës së shumicës në bashkësinë e dhënë kulturore e shoqërore, mes të cilëve personat dygjuhësorë, veç me këtë titull që kanë jo shpesh nxisin dyshim, e edhe kundërshti. Në rastet ekstreme, qysh e paraqet bartjen e formës njëgjuhësore të veçantë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës që janë përzierje etnike, dygjuhësia në vetëdijen e shumicës së banuesve tipikë anglosaksonë asocion me varfërinë, arsimin e dobët e edhe të thuhet me naivitët.</p> <p>Në planin ideor, korelati i qasjes së tillë ndaj dygjuhësisë – të jetë ai i formuluar eksplicit ose vetëm implicit – është besimi se gjuha amtare është shenjtëri e padiskutueshme e cila nuk duron konkurrencën. Gjithkush mundet deri në fund me të të shprehet, kurse gjuhët tjera, të cilat eventualisht më vonë mësohen deri diku, munden vetëm të shërbejnë në kërkesat e</p>	

caktuara pragmatike që nuk prekin në personalitetin intim të njeriut. Duhet thënë menjëherë se me këtë kuptim ekziston bërthama racionale, megjithëse e mbështjellë me mbulesë emocionale. Nëse asgjë tjetër, zotësia me gjuhën e parë në krye është pjesë e procesit të përbashkët të zbulimit të botës dhe vetes në atë botë, ndërkaq pranueshmëria e mëvonshme e gjuhëve tjera, që vjen deri te baza e aftësive të tilla të arritshmërisë, megjithatë mbi të gjitha veprimi gjuhësor. Nga aty edhe lidhja midis mësimin të gjuhës së parë dhe personalitetit, i cili rëndom manifeston edhe nëpërmjet raportit të ngrohtë ndaj asaj gjuhe.

Madhësimi i tillë i një gjuhe amtare dhe të papërsëritshme përshtatet në një mitologji gjithpërfshirëse, të përmendur më herët, për shtetin e pastër kombëtar gjuhësor, në të cilin nuk janë të mirëseardhura asnjë përzierje racore, etnike, fetare dhe gjuhësore. Por edhe nëse e lëmë anash konotacionin mjaft të qartë racist të gjithë kësaj teze, të cilat në historinë më të re evropiane gjithsesi mund të vijnë në shprehje, duhet të konstatojmë se edhe vetë çështja e gjuhës amtare në dritën e caktuar paraqet përthjeshtësinë. Shikuar objektivist, realiteti i sotëm edhe në Evropë, e para së gjithash në botë si tërësi, zbulon fotografi mjaft diferenciale dhe kërkon perspektivë tjetër. Faktet e pamohueshme empirike, si dhe shikimi në rezultatet e arritjeve deri më tani që kanë arritur në këtë fushë disiplina të ndryshme shkencore, tregojnë se pamja e përmendur është e ngushtë, e fiksuar dhe ankronuar nga paragjykimet. Nga aty, mes tjerash, imponohen edhe korrigjime të rëndësishme në kuptimin e nocionit të gjuhës amtare, kurse parakusht metodologjik i pashmangshëm për të është demistifikimi i saj.

Duhet, para së gjithash, kuptuar se vështirësitë fillojnë nga vetë ky term, i cili me metaforizmin e theksuar sygjeron thjeshtësinë natyrore: sikur që çdo njeri ka vetëm një nënë, kështu pra ka edhe vetëm një gjuhë amtare dhe saktë dihet cila. Por gjuha amtare nuk është asesi njëjtë, në nivelin e nocionit, sikur edhe gjuha e nënës. Në praktikë këto dyja shpesh ndeshen, por gjithsesi nuk duhet të jetë ashtu. Ajo që quhet gjuhë amtare mund të jetë edhe gjuha e babait, nëse ajo është tjetër nga e nënës, ose gjuha e personit të tretë ose hapësira e re - veçanërisht në situatat e përzierjes më të madhe etnike dhe kontaktet e gjalla gjuhësore, karakteristike për pakica të ndryshme si dhe popullatën migruese.

Përveç kësaj, nga kushdo që trashëgohet ose merret, gjuha amtare nuk është gjithmonë e vetmja dhe e patjetërsueshmja kategori e dhënë, por në përmbledhje vlerë e ndërrueshme bazike dhe dinamike. Kështu, miliona njerëz nga mbarë bota – masovikisht, psh., në disa pjesë të Indisë – kanë nga dy gjuhë amtare (rrallë, por jo e përjashtueshme, edhe tri), shpesh edhe duke mos e ditur cila nga ato është pikërisht ajo (gjuha amtare). Këtu nuk ndihmon insistimi dogmatik që njëra nga ato duhet megjithatë në të gjitha rastet të ketë përparësi, e cila shpesh tenton të përkrahet me paraqitjet popullore laike të karakterit anekdotik, shembull, nëse te shumëgjuhësorët e vërtetë gjuhë amtare është ajo në të cilën mendohet ose ëndrrohet, ose ajo që mbetet e ruajtur nga çrregullimet ose nga humbjet e pjesërisht të aftësisë gjuhësore për shkak të sëmundjes. Raporti mes gjuhës dhe mendimit, sikur edhe mes gjuhës dhe ëndrrave, është mjaft kompleks, dhe në shumëçka edhe më tutje i patëstuar, për këso identifikime të thjeshta, kurse as evidenca për të sëmurët fizikë nuk jep rezultate të qarta.

Gjithashtu, një gjuhë mund të bëhet amtare në kohën më të hershme, por që më vonë të jetë në atë rol që të ndërrohet me një tjetër si pasojë e ndryshimit të rrethit, e edhe me një të tretë, edhe ate me mundësinë e kthimit në mjedisin origjinal dhe gjuhës së mëparshme letrare e cila tash edhe më shumë forcohet.

Kështu e parë me fleksibilitet, nocioni i gjuhës amtare në të vërtetë mundet të arsyetohet në disa komponente dhe të definohet sipas prejardhjes, ose sipas rendit të vendosur (gjuha e parë e mësuar), shkallën e njhurive (gjuha që më së miri njihet), funksionin (gjuha që më së shpeshti përdoret) ose identifikimin (gjuhën të cilën dikush vet e pranon sikur gjuhë e tij amtare, ose të tjerët në atë kapacitet i përshkruajnë). Këto komponente mund të ndeshen

por edhe të jenë në boshllëk të pjesshëm dhe kështu dikush mund të ketë gjuhë amtare të ndryshme, varësisht nga përkufizimi i përdorur. Megjithatë, me të gjitha kushtëzimet e përmendura, për shumicën e kërkesave më adekuate është përcaktimi i përgjithshëm që njëra gjuhë amtare e dikujt ajo që e para është mësuar nga ai (nëse ajo më vonë nuk është ndërruar) dhe me të cilën vetëm identifikohet. Por edhe më tutje qëndron paralajmërimi se ajo nuk duhet patjetër të jetë vetëm një gjuhë, sepse edhe dy munden me përpjekje të themelohen sikur e para, as edhe të mbetet patjetër gjuhë e njëjtë, jo vetëm për atë që ajo mund të ndërrohet, por sepse edhe vetëidentifikimi u nënështrohet ndryshimeve.

Nga kjo pason edhe kjo, që thënë ashpër, gjuha amtare nuk mund të mos njihet. Në situata migrantësh dhe të ngjashme ia vlen të bëhet dallimi i nocioneve të gjuhës amtare dhe gjuhës së shtëpisë, dhe se, psh., për pasardhësit e punëtorëve tanë në Gjermani të cilët atje janë të lindur, nëse spontanisht e marrin gjermanishten si gjuhë të tyre të parë, kurse gjuhën e të parëve shumë pak e njohin, nuk mund të thuhet që nuk e njohin gjuhën e tyre amtare, ama ajo gjuhë është – gjermanishtja.

Me një fjalë, çështja e gjuhës amtare, edhe në mënyrë teorike e bukur shpesh edhe praktike, është shumë komplekse sesa duket me traditën njëgjuhësore klasike evropiane. Për shkak të paqartësive të përmendura dhe hutive të mundshme, sot në shkencën e problemeve me shumëgjuhësinë, vetë termi gjuhë amtare më shpesh i iket. Në vend të saj, më shumë flitet për gjuhën e parë ose të dytë, derisa këto emërtime thjesht i drejtohen shkallës së njhurive ose në vëllimin e përdorimit, dhe jo patjetër dhe në renditjen për t'u themeluar (përfundim të disiplinave të veçanta siç është psikolinguistika e zhvilluar dhe glotodidaktika, ku kronologjia është e rëndësishme së veçantë).

Plotëso fjalinë ashtu që do të rrethosh shkronjën para përgjigjes së saktë.

Në bazë të leximit të tekstit *Gjuha amtare* të Ranko Bugarskit, domethënia e nocionit *gjuha e parë* nënkupton që ajo është:

- a) Gjuha të cilën e mësojmë para gjuhëve tjera;
- b) Gjuha të cilën më së miri e njohim dhe më së shumti e përdorim;
- c) Gjuha amtare e shumicës së popullsisë në një vend;
- d) Gjuha e cila në një mjedis mendohet si më e vlefshme;

Zgjidhja

b)

Detyra 2

2GJLSH.2.3.4

Niveli i mesëm

Rretho shkronjën para gjyqimit për gjuhën amtare për të cilat autori mendon se janë të sakta

- a) Gjuha amtare duhet të mësohet nga nëna.
- b) Gjuha amtare gjatë jetës mund të ndërrohet.
- c) Gjuha amtare e pasardhësve të emigrantëve është e njëjtë me gjuhën e atdheut të tyre.
- d) Dikush mund të ketë vetëm një gjuhë amtare.

Zgjidhja

b)

Detyra 3

2GJLSH.2.3.5	Niveli i mesëm
Rretho shkronjën para gjykimeve të cilat i përfaqëson autori në lidhje me paragjykimet për dygjuhësisë.	
<ol style="list-style-type: none">Paragjykimet për dygjuhësinë reflektojnë paragjykimet për pakicat kombëtare.Paragjykimet për dygjuhësinë burojnë nga popullimet minoritare.Paragjykimet për dygjuhësinë janë të bazuara në kërkimet shkencore.Paragjykimet për dygjuhësinë janë karakteristike vetëm për Shtetet e Bashkuara të Amerikës.Paragjykime për dygjuhësinë kanë veçanërisht ata që zotërojnë vetëm me një gjuhë	
Zgjidhja	
e)	

Detyra 4

2GJLSH.2.3.5.	Niveli i mesëm
Shkruaj tri argumente të autorit kundër termi <i>gjuha amtare</i> .	
1. _____	
2. _____	
3. _____	
Zgjidhja	
Përgjigjja e pranueshme	
Secila përgjigje e cila përmbanë këto informata:	
<ol style="list-style-type: none">Gjuha amtare nuk është njëjtë sikur gjuha e nënës;Dikush mund të ketë dy gjuhë amtare;Gjuha amtare mund të ndërrohet.	

Detyra 5

2GJLSH.1.3.7	Niveli bazë
Nënvizo në paragrafin e dytë të pjesës së tekstit në të cilën autori argumenton në interes të besimit se “gjuha amtare është shenjtëri e padiskutueshme e cila nuk duron konkurrencë”.	
Zgjidhja	
<u>Nëse asgjë tjetër, zotërimi me gjuhën e parë në parim është pjesë e procesit të unifikuar të zbulueshmërisë së botës dhe vetes në atë botë, kurse e fundit është pranimi i gjuhëve tjera, deri te e cila arrihet në themel të atyre aftësive të arrira, megjithatë mbi të gjitha operacioni gjuhësor.</u>	

Detyra 6

2GJLSH.2.3.5	Niveli i mesëm
Cili është qëndrimi i autorit në paragrafin e fundit? Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.	
a) Në paragrafin e fundit autori në mënyrë decisive thotë se duhet dhënë termi <i>gjuhë amtare</i> . b) Nga paragrafi i fundit nuk mund të sjellim përkufizim për qëndrimin e autorit në lidhje me termin <i>gjuhë amtare</i> . c) Autori në paragrafin e fundit nuk thekson asnjë qëndrim në lidhje me termin <i>gjuhë amtare</i> . d) Në paragrafin e fundit autori implikon (sugjeron) se termi <i>gjuha amtare</i> duhet lëshuar në interes të termit <i>gjuha e parë</i> .	
Zgjidhja	
d)	

Detyra 7

2GJLSH.3.3.5	Niveli i lartë
Si autori në përgjithësi në tekst tregon se pajtohet me atë që termi <i>gjuha amtare</i> duhet ndërruar me termin <i>gjuha e parë</i> ? Vlerëso mjetet (psh., faktet, mendimet etj.) të cilat i shfrytëzon dhe argumento mendimin tënd.	
Shkruaj së paku dy shembuj.	
1. _____	
2. _____	
Zgjidhja	
Përgjigjja e pranueshme	
Secila përgjigje në të cilën nxënësi vlerëson së paku dy mjete të cilat i thekson autori. Mjetet i emëron (rezymon) ose edhe i parafrazon. Psh.: Autori në përkufizim thotë mendimin e huaj; u refereohet argumenteve; ata të cilët eventualisht mund të japin mendim të kundërt – ata i thekson në kllapa sikur më pak të rëndësishëm.	

Detyra 8

2GJLSH.2.3.4

Niveli i
mesëm

Lexo me kujdes tekstin e dhënë për dramën *Hamlet* të Shekspirin dhe përgjigju sipas kërkesave poshtë tekstit

Për Hamletin

Duke filluar nga Gëte, kritika letrare ka menduar se Hamleti është njeri i vullnetit të dobët. Ky kuptim gjeti shprehje përfundimtare te Berni i cili në artikulin e tij, të shkruar me tonin e pamfletit, e përqeshi Hamletin, veçanërisht duke ngritur mbretin. Edhe mendimtari origjinal sikur Hebeli shkruan shumë figurshëm në “Ditarin” e vet: “Hamleti është një mbeturinë qysh para fillimit të tragjedisë; ajo që ne shohim janë lule dhe gjemba të cilat rriten nga kjo mbeturinë”. Në letërsinë ruse është i njohur artikulli i Turgnjevut “ Hamleti dhe Don Kishoti”, i cili jep një karakteristikë mjaft interesante për Hamletin, duke ndeshur intelektualitetin e pavullnetshëm të tij aktivitetit të menjëhershëm të Don Kishotit. Këtë kuptim e bazon në qasjen e pastërt letrare të tragjedisë, në atë besimin e verbër nga materiali i folur, të cilin nganjëherë e dallon kritika më masive letrare. Bazë për interpretim të tillë jep vetë Hamleti në monologun e vet të njohur, në të cilin ia zë për të madhe vetes për vendosmërinë e pamjaftueshme.

Çka është ai për Hekubën? Çka është ajo për të?

Kurse unë

Mirëpo, sikur që është thënë, ato monologje paraqesin shtytje për veten, vullnetin e tij, kurse më së paku dëshmojnë për lightësi të atij vullneti. Nëse doni, përkundrazi, njeriu që vërtetë ka vullnet të dobët më shpesh nuk është i vetdijshëm për atë dobësi; ekziston një thënie publike në të cilin një i ligësht shtrihet në divan dhe falënderohet: “Unë jam shqiponjë” etj. Në vetvete, monologjet e Hamletit flasin vetëm për atë që ai nuk është i kënaqur me veten dhe – asgjë më shumë. Duke luftuar me rrethin feudal, ai lufton me vetveten, e mund në vete dyshimin e moralit të ri humanistik i cili kërkon më shumë drejtësi. Por këto luhatje askund nuk e paralizojnë vullnetin e tij. Tragjedia e Hamletit shtrihet në aspiratën e tij të vetmuar, pa bazë të mjaftueshme për drejtësi. Sikur që është thënë tashmë, heroit të dramës nuk mund t’i besohet në fjalë, duhet parë se si vepron. Aktiviteti i Hamletit është aq energjik sa që ai vet zhvillon luftë të gjatë e të përgjakshme me mbretin, me tërë oborrin (mbretëror, vj.) danez. Në dëshirën e zjarrtë të tij tragjike për të vënë drejtësi, ai tri herë vendosmërisht sulmon mbretin: herën e parë vret Pollonin, herën e dytë mbretin e shpëton lutja e tij, kurse herën e tretë, në fund të tragjedisë, Hamleti vret mbretin. Hamleti jashtëzakonisht ashpër e shpik “gjuajtjemiun” – spektaklin, duke kontrolluar deklaratën e shpirtit; Hamleti me shkathtësi largon nga rruga e tij Rozenkranin dhe Gildensternin. Vërtet, ai zhvillon luftë titanike. Nuk u beson deklaratave të shpirtit, veç se ato deklarata i kontrollon; ky kontroll deri diku mban goditjet kryesore. Por as këtu nuk kemi shenja të vullnetit të dobët. Me vullnetin e autorit, shpirti nuk lajmërohet si profet, të cilit duhet t’i besohet, veç si fantazmë e frikshme dhe e dyshimtë. Karakterit të fortë e elastik të Hamletit, i përgjigjet natyra e tij fizike; Laerti është luftëtari më i mirë me shpatë i Francës, kurse Hamleti e mund, tregohet luftëtar më i shkathët (sikur kjo kundërthënie e gjykimeve të Turgnjevut se Hamleti është fizikisht i dobët!). Heroi i tragjedisë ka vullnetin në maksimum, tragjedia është gjithmonë tragjedi e forcës, dhe ne nuk do të kishim ndjerë efektin tragjik të cilin e nxit “Hamleti” që heroit ishte i pavendosur dhe i dobët.

(Fragment nga libri Dramaturgjia, Vladimir Volkenshtajn, 1966)

Rretho parimin themelor në bazë të të cilit Hamleti është caktuar si hero dramatik.

- a) Parimi i veprimit
- b) Parimi i bukurisë fizike
- c) Parimi i komplotit
- d) Parimi i kostumit skenik

Zgjidhja

a)

Detyra 9

2GJLSH.3.3.5

Niveli i lartë

Lexo fragmentet e dhëna për romanin dhe përgjigju sipas kërkesës poshtë tekstit:

Zgjidhja

Literatura:

1. Aliu, Ali, dhe etj. (2010). *Gjuha shqipe dhe letërsia 4 Per vitet e katerta te gjimnazit te reformuar*. Tiranë/Tetovë/Prishtinë: Sh.B Albas
2. Bahri B. (2004). *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*. Tiranë: Botime EDFFA/
3. Hamiti, dhe etj. (2010). *Gjuha shqipe dhe letërsia 1 Per vitet e para te gjimnazit te reformuar*. Tiranë: Sh.B Albas, Tiranë
4. Hamiti, S, dhe etj. (2010). *Gjuha shqipe dhe letërsia 3*
5. *Per vitet e treta te gjimnazit te reformuar*. Tiranë-Tetovë/Prishtinë: Sh.B Albas
6. Kelmendi A, dhe etj. (2002). *Gramatika e gjuhës së sotme shqipe – Sintaksa për shkollat e mesme*. Prishtinë: Enti Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës
7. Lloshi, Xh. (1999). *Stilistika dhe Pragmatika. Tekst mësimor*. Tiranë: Botimet Toena.
8. Memushaj R. dhe etj. (2003). Vlorë: “Pavarësia”.
9. Petro, R. dhe etj. (2008). *Çelësi i letërsisë dhe i gjuhës shqipe*. (2009). Prishtinë: Sh.B Albas
10. Topalli, K. (2000). *Shndërrime historike në sistemin zanor të gjuhës shqipe*. Tiranë: Akademia e Republikës së Shqipërisë.
11. Thomaj, J. (1977). *Leksikologjia e gjuhes shqipe*. Prishtinë: ENTI I TEKSTEVE DHE I MJETEVE MESIMORE KRAHINES SOCIALISTE AUTONOME TE KOSOVËS.
12. Grupa autora (2015). Српски језик и књижевност. Београд: Завод за вредновање квалитета образовања и васпитања.